



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

T R A N S K R I P T

**I MBLEDHJES SË JASHTËZAKONSHME TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS
SË KOSOVËS, E MBAJTUR MË 11 DHE 30 TETOR 2024**

**SA VANREDNE SEDNICE SKUPŠTINE REPUBLIKE KOSOVA,
ODRŽANE 11. I 30. OKTOBRA 2024. GODINE**

**TETOR - OKTOBAR
2024**

Rendi i ditës

1. Debat parlamentar për komunikimet e kryetares së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari - Lila, me Milan Radojçiq.

Dnevni red

1. Parlamentarna rasprava o komunikaciji predsednice Poslaničke grupe Lëvizja Vetevendosje Mimoze Kusari - Lila sa Milanom Radojčićem.

Mbledhjen e drejtoi nënkryetari i Kuvendit, z. Enver Hoxhaj.

KRYESUESI: Të nderuar deputetë,

Më lejoni t'i hap punimet e seancës së jashtëzakonshme të Kuvendit të Republikës së Kosovës me kërkesën e 41 deputetëve të Kuvendit.

1. Debat parlamentar për komunikimet e kryetares së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari - Lila, me Milan Radojçiq

41 deputetë të Kuvendit të Republikës së Kosovës, në bazë të nenit 69, paragrafit 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe neni 68 paragrafi 3 të Rregullores së Kuvendit kanë parashtruar kërkesë për seancë të jashtëzakonshme për debat parlamentar për komunikimet e kryetares së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Mimoza Kusari-Lila, me Milan Radojçiq, si dhe kanë parashtruar një propozim-rezolutë për miratim.

Ftoj zotin Abelard Tahiri, kryetar i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, që në emër të deputetëve nënshkrues të paraqesë çështjen për të cilën është kërkuar kjo seancë e jashtëzakonshme.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit, kryesues i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuara media,

Është vërtet fatkeqësi e madhe për këtë Kuvend dhe për një shumicë prej 50% që i ka fituar zgjedhjet dhe t'i ikë ballafaqimit me të vërtetën. Këtë nuk e kemi parë asnjëherë në të kaluarën dhe shpresoj që të jetë hera e fundit që po e shohim kështu, pra ku vendi ku do të duhej të ishte zonja Mimoza Kusari-Lila, së bashku me deputetët e Lëvizjes Vetëvendosje, ata të cilët na e kanë sjellë në këtë Kuvend Milan Radojçiqin, të jenë sot dhe të ballafaqohen me të vërtetën.

Po ashtu, ajo që është shumë e rëndësishme dhe pikërisht në këtë foltore zonja Mimoza Kusari-Lila pati edhe aludime që do të nxjerrin edhe fotografi, dhurata, pamje nga përrurimi i shtëpisë së Radojçiqit me zyrtarët e shtetit të Kosovës. I bëra thirrje edhe dje, i bëj thirrje edhe sot që është në interes të shoqërisë dhe të shtetit të Kosovës të shihet se kush janë ata njerëz që kanë marrë pjesë në përrurimin e shtëpisë së Radojçiqit, kush janë njerëzit që kanë dërguar dhurata për familjen dhe për fëmijët e tij, pra është në interes, sepse një gjë e tillë e cenon sigurinë kombëtare të vendit tonë.

Të nderuar kolegë deputetë, para se të ndodhte Banjska çështjen e komunikimit mes Milan Radojçiqit dhe Lëvizjes Vetëvendosje përmes shefit të grupit parlamentar e kam parë me një sy tjetër. Pra, ka qenë diçka që e ka cenuar sigurinë tonë kombëtare, ka qenë një fenomen shumë negativ me një person, i cili është në listën e zezë të Shteteve të Bashkuar të Amerikës, një

person i cili ka një të kaluar kriminale jashtëzakonisht të rrezikshme, i dëmshëm për qytetarët e Kosovës sikur për ata të komunitetit serb, po ashtu edhe për komunitetin shqiptar, por nuk e kam pasur alarmin, të cilin e kam sot mbas Banjškës kur i dëgjojmë bisedat e Milan Radojçiqit me Mimoza Kusari-Lilën.

Pse është një gjë e tillë? Gjithmonë prej perspektivës time. Sepse, tashmë e shohim që Milan Radojçiq nuk është thjesht një kriminel ordiner, i cili ka ardhur në Kosovë dhe e ka bërë një sulm dhe pastaj do të duhej të arrestohej nga prokurorët dhe policia serbe, sepse iku në Serbi, ne s'arritëm ta kapnim. Milan Radojçiq është një person i cili e ka mbështetjen e madhe të Presidentit serb, Aleksandër Vuçiq. Milan Radojçiq është një person i BIA-s serbe.

Pra, fatkeqësisht kemi mbërritur në një pikë, ku BIA serbe, shërbimet serbe përmes Milan Radojçiqit të Lëvizja Vetëvendosje, përmes Mimoza Kusari-Lilës ne na kanë imponuar agjendën e Kuvendit. Dhe, ajo çka më intereson sot mua është të shoh se cilat janë projektligjet dhe se cilat janë politikat që Lista serbe, nën ndikimin e Milan Radojçiqit, së bashku me Lëvizjen Vetëvendosje i kanë miratuar nga marsi i vitit 2021 deri në tetorin e vitit 2022. Cilat janë çështjet e përbashkëta që këta i kanë shtyrë? Sepse, tashmë del qartë që kjo është një periudhë ku këta kanë pasur një bashkëpunim. Pra, çka ka votuar Kuvendi i Kosovës bashkërisht me Listën serbe dhe Lëvizjen Vetëvendosje, të shtyrë nga Milan Radojçiq, e që kanë qenë kërkesa të BIA-s serbe, të presidentit serb.

Edhe më të rëndë e bën fakti që nuk kemi evidencë të votimeve, nuk kemi evidencë të votimeve se çka ka kaluar në këtë Kuvend gjatë kësaj periudhe, i kemi ngritur duart, pra e vetmja evidencë janë kamerat, pamjet televizive që mund të na i sjellin dhe t'i shohim cilat janë çështjet që kanë kaluar dhe ato mund të mos jenë të plota. Pra, imagjinoni, nuk e kemi një rekord të votimeve që janë shtyrë gjatë kësaj periudhe prej këtyre aktorëve, nuk e kemi një rekord, nuk kemi kurrfarë votimi tek tani në fund të legjislaturës ne e kemi votimin elektronik që do duhej të ishte në fillim.

Pra, të nderuar kolegë deputetë, ne i dimë vetëm dy çështje. Cilat janë ato dy? Pra, ne e dimë që Milan Radojçiq na e ka përcaktuar pagën minimale së bashku me Mimoza Kusari-Lilën. Kjo është një diçka që e kemi dëgjuar me veshët tonë dhe të tjerat nuk i dimë, po ashtu e dimë që Milan Radojçiq së bashku me Mimoza Kusari-Lilën dhe Lëvizjen Vetëvendosje i kanë lënë jashtë pagës minimale kategoritë më të ndjeshme të vendit tonë: veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, invalidët e luftës, ata që lanë gjymtyrët e tyre në frontet e luftës, i kanë lënë jashtë pagës minimale nënat e dëshmorëve, ata që bijtë e tyre ranë dëshmorë, fëmijët e dëshmorëve, pra përcaktim i tyre ka qenë, jashtë pagës minimale.

Pra, paga minimale duhet të jetë ai minimumi me çka mund të jetojë një familje në vendin tonë. Pra, edhe jashtë atij minimumi i kanë lënë. Angazhimin e tyre të përbashkët e kemi parë po ashtu për Gjykatën Kushtetuese, pra Milan Radojçiq, Mimoza Kusari-Lila dhe dy grupet e tyre

parlamentare fatkeqësisht kanë pasur një kandidat të përbashkët për Gjykatën Kushtetuese. Nuk është tragjike të ketë kandidatë të përbashkët një grup parlamentar që vjen nga komuniteti serb, sepse nuk dua të keqkuptohem, është krejt normale të kemi një bashkëpunim përfaqësuesit e komunitetit serb në Kuvendin e Kosovës edhe të kenë një kandidat të përbashkët me një grup tjetër parlamentar, kurrëgjë tragjike s'është. A dinë çka është tragjike? Tragjike është kur kandidati na vjen nga një njeri me aktivitet të rëndë kriminal, nga një njeri i cili vjen nga BIA serbe, nga intelijenca serbe dhe e ka mbështetjen e komplet shtetit serb. Pra, shtetit serb i kërkon Makroni ta arrestojë Radojçiqin, i kërkon Shollci ta arrestojë Radojçiqin, i kërkon ambasadori amerikan, Kristofor Hill, ta arrestojë Radojçiqin dhe ai është i lirë, sepse ai është një prej udhëheqësve të shtetit serb.

Dhe, ai na e ka imponuar agjendën tonë në Kuvendin e Kosovës. Pra, ky Kuvend, të nderuar kolegë deputetë, është i kontaminuar, e kanë kontaminuar dhe e kanë kriminalizuar. Pra, duhet pasur një hetim të thellë e të shohim deri ku ka mbërritur vendimarrja në këtë Kuvend që është shtyrë nga Milan Radojçiqi. Cilat janë çështjet, e që fatkeqësisht, e thashë, duke pasur parasysh që nuk e kemi një evidencë të votimeve e të shohim qartë se çka është shtyrë nga ata, fatkeqësisht goxha e bën të pamundur të mbërrijmë deri te një situatë e tillë dhe të kemi një pasqyrë të qartë.

Unë i kërkoj sot prokurorit të shtetit që të ketë një hetim penal mbi këtë çështje. Është cenuar siguria jonë kombëtare, BIA serbe na e ka imponuar votimin në Kuvendin e Kosovës, na ka depërtuar deri në Gjykatën Kushtetuese. Kjo është e patolerueshme, nuk jemi cenuar asnjëherë më shumë se sa kësaj here, asnjëherë. Unë po të kisha qenë në pozitën e tyre, për besë, ndoshta edhe e kisha pasur rëndë të vija e të ballafaqohesha me një çështje, se po duket të jetë e rëndë. Por, të vërtetës nuk mund t'i iket. Sot po ikin prej kësaj seance, por nesër nuk do të mund të ikin. Ata do të japin përgjegjësi me çka, cila agjendë ka qenë ajo dhe cilat kërkesa ia kanë përmbushur pjesëtarit të BIA-s në Kosovë, Milan Radojçiq. Çka i kanë përmbushur ata? Çka i kanë shtyrë ata? Cilat janë çështjet të cilat i kanë shtyrë së bashku me Milan Radojçiq? Faleminderit!

KRYESUESI: Të nderuar kolegë deputetë, tash po shkojmë sipas radhës së grupeve parlamentare. Dua ta ftoj përfaqësuesin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, kryetarin e grupit apo ndonjë përfaqësues.

Zoti Quni e ka fjalën.

ANTON QUNI: Faleminderit, zoti kryesues!

Të nderuar deputetë,

Përkundër asaj që nuk i kemi prezentë këtu deputetët e Vetëvendosjes dhe Kabinetin qeveritar, unë do t'u drejtohem në mënyrën që së paku atë virtualisht po e përcjellin këtë seancë.

Isha i bindur se pas çlirimit të Kosovës, shpalljes së pavarësisë, forcimit të shtetit, ngritjes së cilësisë së demokracisë, aleancave të shëndosha me partnerët tanë strategjikë, cilado qeveri në asnjë rrethanë për të shtyrë agjendat, proceset dhe veprimet e saj nuk do të ngushtohet apo të detyrohet që të aranzhojë marrëveshje jashtë praktikave, normave morale, jotransparente, larg syve të publikut të mbajtura në fshehtësi e të kushtëzuara nga njeriu më i kërkuar për akte kriminale, me fletarrestim ndërkombëtar, i vendosur në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, Milan Radojçiq.

Po ashtu, isha i bindur se betimi i deputetit është betim që buron nga zemra dhe shpirti, është fjalë e dhënë, është besë para qytetarëve e miqve se në asnjë rrethanë deputeti nuk e vendosë interesin personal para atij kombëtar e shtetëror. Është e paimagjinueshme që një deputet e përdhos këtë betim, fjalë e besë, duke arritur marrëveshje me kryekriminelin Milan Radojçiq. Nuk mund të imagjinoj se si një deputet te varri i heroit Afrim Bunjaku, në prani të familjes përkulet, vendos lule e përlotet. Ngushëllon familjarët e kolegët, duke e ditur se ai është i vrarë nga njeriu me të cilin ti kohë më parë ke bërë marrëveshje të fshehtë, nga terroristi Milan Radojçiq.

Të nderuar deputetë, grupi paramilitar i udhëhequr nga Radojçiqi është vazhdimësi e grupeve paramilitare që gjatë viteve të '90-ta shkretuan në Kroaci, Bosnjë e Hercegovinë dhe së fundmi në Kosovë. Ky formacion ishte i përbërë nga llumi i mbetur i paramilitarëve, “tigrat”, “shqiponjat e bardha”, “çakallët”, “akrepat” e tjerë. Por, me qëllimin, me natyrën e njëjtë që të djegin, të shkatërrojnë, të dhunojnë e të zhdukin çdo gjë që nuk është serbe. E të hysh në marrëveshje të fshehtë me njerëz të sojit të tillë, ke hyrë në marrëveshje me vetë djallin. E për çka? Për cilin çmim? Për çfarë kënaqësie? Për çfarë ideali? Për të ruajtur një pozitë? Për të marrë një pagë? Për të punësuar një hallë apo teze? Për të fituar një tender? Për të zhvatur fondet? E me çdo kusht për t’ia vazhduar jetën qeverisë. A ia vlen? A ia vlen që një marrëveshje e fshehtë me vrasësit të abuzohet me çlirimtarët, kolegun të shpallësh tradhtar, prokurorin të shitur, policin të manipuluar, e minatorin sabotues.

Si është e mundur, nga buron kjo energji që çdo gjë që nuk është Vetëvendosje, çdo gjë që nuk pajtohet me Vetëvendosje, çdo gjë që nuk frymon me Vetëvendosjen qenka e dyshimtë, kriminale e tradhtare, e që ju i kërcënuat, linçuat, përndoqët dhe i rrezikuar me gaz molotov e gjemba dhe e vërsulët me ushtrinë kibernetike. Kurse, për një ligj që ua vazhdon jetëgjatësinë i sollët të ulen këmbëkryq në këtë sallë të Kuvendit të dëgjueshmit e Milan Radojçiqit. A e kuptoni, a jeni të vetëdijshëm ju që e keni fituar besimin e qytetarëve, që ju besuan verbërisht, që ju ngritën lavde, ju verifikuan, ju thurën këngë e besa ngritën edhe shtatore për liderin tuaj, duke menduar se jeni më të diturit, më të guximshmit, më trimat, më të pastërtitë, ajka e kombit. Që nga sot e rrënuat çdo ëndërr, shuat çdo shpresë, na keni mbyllur çdo shteg. Ju që kriminelit iu gjunjëzuar: “Aman, ejani e na shpëtoni”, e keni poshtëruar këtë Parlament. Na keni larguar

skajshmërisht, e keni rrënuar dinjitetin e çdo qytetari, na keni turpëruar para gjithë botës. I drejtohem zonjës Kusari Lila, më besoni se po më dhimbsoni, seriozisht kam dhimbje për ju.

Nuk jeni fajtori kryesor, fajtori kryesor është lideri juaj, kryeministri Albin Kurti, nuk e di se si ju ka detyruar që të aranzhoni marrëveshje me kriminelin, krijesën e Inteligjencës së Serbisë. Por, kuptojeni se jo për mbretin tuaj në tabelën e shahut nuk jeni mbretëresha e tij, nuk jeni as piun i tij, me këto kapërcime që i bëni nga tabori i tij e kaloni në taborin e kundërshtarit, e prapë ktheheni mbrapa te mbreti kur i ka punët keq, a po e dini se cila figurë e shahut jeni për mbretin tuaj. Ju e keni mundësinë të tregoni pak moral, të tregoni se edhe në politikë ka moral. Është mirë të rrëfëheni, të kërkonit falje, dhe me vrap të shkoni te prokuroria dhe mos prisni që ata t'ju thërrasin. Shkoni vetë dhe hiqeni atë barrë me të cilën ju kanë ngarkuar. Është e vetmja mënyrë për t'ia kryer një shërbim të mirë kombit dhe shtetit.

Ne, Lidhja Demokratike e Kosovës, ashtu siç na ka mësuar ati themeltar i Republikës së Kosovës, Presidenti historik Ibrahim Rugova, e kemi një porosi për të gjithë ju: nuk mbrohet partia duke e rrënuar shtetin, nuk mbrohet lideri duke e rrënuar kombin dhe kurrë po kurrë nuk thirret fqinji në ndihmë për ta luftuar vëllain. Faleminderit!

KRYESUESI: Tash, dua ta ftoj kryetarin apo përfaqësuesin e Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës. Zoti Haradinaj e ka fjalën.

RAMUSH HARADINAJ: I nderuar kryesues i Kuvendit,

Të nderuar deputetë,

Së pari, më lejoni t'ju jap disa të dhëna që u ndihmojnë qytetarëve të vendit e gjithë juve. Radojçiqi është i ndjekur nga drejtësia e Kosovës nga v. 2018. Pra, Policia e Kosovës atëkohë, ka rastisur që kam qenë kryetar Qeverie, po këtë s'e ka bërë Qeveria, e ka bërë drejtësia e Kosovës, e ka bastisur banesën e tij në veri të Mitrovicës. Që atëherë Radojçiq e ka lëshuar Kosovën. Pra, është i ndjekur nga drejtësia dhe i ikur në Kosovë. Atëkohë ishte nënkryetar i Listës serbe. Që nga ajo kohë, që nga ajo ditë e bastisje, kryetari i atëhershëm i Qeverisë, Ramush Haradinaj, deputeti i sotëm, kryetari i Aleancës s'ka komunikim me z. Radojçiq të çfarëdo natyre. Kush ka çfarëdo të dhëne të këtij komunikimi, e lus qiteni publikisht sot e kur të doni.

E dyta, kur e ka ndjekur drejtësia jonë atëkohë, ai ka pasur të drejtat e veta t'ju përgjigjet drejtësisë dhe të vijë të përballet me ligj. E ka zgjedhur një rrugë tjetër, atë të ikjes nga drejtësia. Si i ikur, pra, ndikimi i tij në proceset e brendshme në Kosovë, është rishfaqur me ardhjen në pushtet të Albin Kurtit. Pra, një njeri i ikur nga Kosova, me pamundësi të operojë në Kosovë, pa fuqi të vendimmarrjes në Kosovës, na u ringjall me ardhjen e Albin Kurtit kryeministër.

Ka mbërritur, pra, situata e tillë nga ajo kohë që kur Vetëvendosje e shumë të tjerë me të drejtë kishin mendimet e tyre dhe kritikën e tyre për rolin e tij, edhe të mëhershëm, kur ishte ende i

përndjekur nga drejtësia kosovare, pra ka mbërritur që ai të kthehet në faktor me ardhjen e Vetëvendosjes në pushtet dhe te z. Kurti. Deri ku shkon ky faktorizim i tij, përkundër faktit, që përpos që ishte i ndjekur nga drejtësia e Kosovës, ai u vendos edhe në listën e zezë të SHBA-së. Rezultoi që gjatë kohës së qeverisjes së Albin Kurti, ai, pos banesës që e kishte në veriun e Mitrovicës, e të cilën e bastisi Policia e Kosovës, ai ndërtoi një vilë të madhe të bukur, në breg të liqenit atje. Edhe jo vetëm kaq, por arriti edhe të lidhë marrëveshje me Albin Kurtin. Pra, edhe si i ndjekur nga drejtësia e Kosovës, edhe i përfshirë në listën e zezë të SHBA-së. Tani, shiheni dallimin! Më 2018 i ndjekur nga Qeveria Haradinaj, në këtë rast nga drejtësia e asaj kohe në atë Qeveri, tani Radojçiq u kthye në faktor të marrëveshjeve me Kurtin.

Si ndodhi marrëveshja? Unë kam qenë në këtë seancë, e nuk i kam ditur përgjimet. Kam qenë në këtë seancë, kam qenë i ulur atje ku ulem zakonisht e s'kam mundur t'u besoj syve të mi, hera e parë dhe e vetme që i kam parë partitë shqiptare dhe Listën serbe duke votuar bashke kundër UÇK-së. Atë kohë, kam thënë, Rrahman Morina u kishte marrë lakmi. Pa i ditur ato përgjime. Pa i ditur, por ky ka qenë deklarimi im në këtë seancë. Ju kërkoj falje të gjithë, po kështu i kam thënë.

Me daljen e përgjimeve, unë mendoj që situata është si vijon. Pra, së pari ne po i gjuhemim në qafë Kusari-Lilës, me të drejtë se ajo është zbatuesja, por mos të harrojmë që ajo është vartëse e Albin Kurtit. Marrëveshjen Lista serbe-Vetëvendosje për t'i larguar veteranët, pra kategorinë e lirisë të mos përfshihen në pagën minimale, e ka bërë, ju lutem, Albin Kurti me Radojçiqin. Po unë nuk them me Radojçiqin, unë them me Vuçiqin.

Pra, mos e harroni këtë! Këtu dal te ajo që po e them çdoherë, që Kurti është spiun i Serbisë. Është njeri i Serbisë, s'mund të jetë ndryshe. Tash, po ju tregoj rend e rend, pse është spiun i tyre. Nëse më 2018 paska qenë gabim të takohet Radojçiqin si nënkryetar i Listës serbe, i pandjekur nga drejtësia e Kosovës, pa asnjë akuzë në Kosovë, i papërfshirë në listën e zezë të Amerikës, çka është komunikimi me të pasi e ndjek drejtësia e Kosovës. Pra, pasi ka aktakuzë prej Kosovës, pasi e fut në listë të zezë Amerika, çka është kjo? Është veç larje e borxhit ndaj Serbisë, ndaj Vuçiqi, ndaj BIA-s, ndaj të gjithë të tjerëve. Pra, Kurti po i lanë borxhet. A ka akt më transparent të tradhtisë se sa të bëhesh me armikun kundër luftëtarëve të lirisë. Janë akuzuar këtu veç e veç secili subjekt politik që ka pasur bashkëpunim me Listën serbe për të qeverisur, që buron nga Kushtetuta e vendit, që nuk është jashtëligjshëm, ndërsa vetë Kurti në fund ka bërë marrëveshje me Vuçiqin kundër UÇK-së. Është një dallim, ju lutem, kush di ta shohë këtë.

Pse e bën këtë marrëveshje? Pse guxon Kurti ta aprovojë në bazë të kësaj marrëveshje me Radojçiqin dhe Vuçiqin? Po lanë borxh. S'ka shqiptar tjetër normal që e kishte bërë këtë. Ky po lanë borxh. Është i zënë prej tyre. Ky është spiuni i tyre. Nëse nuk e shihni kështu, s'di si mund ta shohim ndryshe. Më mirë do të ishte të vinte Kurti në këtë foltore, të mos e linte Kusarin të përballej me të bëmat e saj si në varëse, po të vinte të fliste vetë, pse e ka bërë dhe si e ka bërë.

Tani, nuk është vetëm kjo që na dëshmon që ky është spiuni i Serbisë, Albin Kurti, edhe që është i tyre, që është i lidhur me ta, ata nuk e lëshojnë lehtë. Neve na jepet fotoja sot e përgjimeve ose e Sveçlës dhe Krasniqit në veri. Për aso fotosh, u tregon Rashit Qalaj, fotot që i ka Kosova kur i kanë bastisur, kur i kanë ndalur takimet e Listës serbe, kur i kanë sjellë gjysmëzhveshur në Prishtinë, qysh janë hapur rrugët për të shkuar në veri, edhe a ka guxuar kush t'i zërë rrugët në kohë të qeverisjes sonë.

Në vend që të na japë foton e korrikut në Uashington, kur ishte Samiti i 75-të i NATO-s, në Amerikë, jubilar i 75-të, që Kosova e ka pasur mundësinë të ulet në atë samit, si kandidate, ashtu si e përfundoi me sukses Finlanda e Suedia, Albin Kurti po na e jep fotografinë e Sveçles duke bërë showbiz në veri. Nuk janë Kosova aq të padijshëm sa të kujtojë Albin Kurti e Sfeçla që mund të na e fshehin fotografinë e Uashingtonit në tavolinë të NATO-s, me fotografinë e 'sfekllës' në veri.

Ky është duke e bërë punën e Serbisë, ju lutem! Nëse s'e marrim vesh me kohë, të gjithë do të jemi bashkëfajtorë. Aleanca pra e mbështet kërkesën për llogaridhënie të zonjës në fjalë, por mendojmë se llogari duhet të japë shefi i saj, Albin Kurti.

KRYESUESI: Tash e ftoj përfaqësuesin e Partisë Demokratike, znj. Hoxha.

ELIZA HOXHA: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Po e nis këtë fjalë me një pyetje, se çfarë ka të jashtëzakonshme, ose a duhet të jetë e jashtëzakonshme të flasësh me një serb? A duhet të jetë dhe pse duhet të jetë kjo çështje e jashtëzakonshme, kur e dimë se janë kategori kushtetuese në Kosovë?

Por, të flasësh me një serb, të cilin Kosova e përndjek nga v. 2018, si u tha edhe më herët këtu, Amerika e ka futur në listën e zezë nga viti 2021. Të koordinohesh me të për vendimet në Kuvendin e Kosovës, të përgojosh aktorët e partive politike me ta, të cenosh të drejtën e veteranëve të luftës për mirëqenie me të, është tepër e jashtëzakonshme. Jo vetëm e jashtëzakonshme, por në fakt, e jashtëligjshme dhe kundërkushtetuese.

Ja ku jemi sot në një seancë të jashtëzakonshme, sepse llogaridhënia e kësaj mazhorance dhe e kësaj Qeverie është bërë e pamundur në kushte të zakonshme të punës së Kuvendit të Kosovës. Siç po e shihni, nuk janë këtu, sepse nuk duan të japin llogari për asnjë veprim që e bëjnë.

Një vit më parë, kur dolën përgjimet e aferës 'Zdravo', edhe në fjalimin tim hyrës, në minutat jashtë rendit të ditës, por edhe pas degradimit dhe konfliktit në seancë, e kujtoj një pyetje që ia kam bërë dy herë z. Kurti. A qëndron ai prapa bisedës dhe kërkesave që znj. Kusari-Lila dëgjohej duke i diskutuar me Radojçiqin në audio-incizim? Përgjigjen nuk e morëm atëherë. Por,

sot e kemi përgjigjen e tij në audio-incizimin e dytë, ku znj. Kusari-Lila i kërkohet nga Radojçiq që të koordinohet me shefin e saj, pra me Albin Kurtin.

Le ta shpalosim pak kontekstin. Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje ndër vite ka linçuar dhe demonizuar, kanë shpallur kriminelë e tradhtarë nga radhët e aktorëve politikë shqiptarë, të gjithë ata që kanë komunikuar, diskutuar e bashkëpunuar në baza institucionale me cilindo serb në Kuvendin e Kosovës. Të njëjtit ndër vite e kanë përbuzur dhe problematizuar dialogun me Serbinë dhe të gjitha marrëveshjet e arritura në atë periudhë. Kanë shkuar aq larg saqë në zgjedhjet lokale dhe në zgjedhjet qendrore talleshin duke thënë se dialogu është prioriteti i shtatë ose jashtë fokusit dhe prioritet do të jetë dialogu me serbët lokalë.

Çfarë pamë ndërkohë, janë dy lëvizja paralele si peizazhe paralele. I pari për të kënaqur ndjenjat e shqiptarëve me nacionalizëm e popullizëm në emër të sovranitetit në veri, duke përjashtuar serbët lokalë dhe dialogun me ta. I dyti, koordinim me Radojçiqin, tashmë i ndjekur edhe për terrorizëm për t'i përjashtuar veteranët nga paga minimale dhe për t'i futur duart në gjyqësinë e Kosovës.

Realiteti i parë zyrtar, ndërsa realiteti i dytë, tinëzar e në prapavijë, i dëmshëm dhe shumë i frikshëm. Nëse flasim drejt, nuk do të ishte dashur asnjëherë që vota e një deputeti serb, apo kërkimi i votës së tyre të shihej si krim, sepse ata janë pjesë e Kuvendit dhe e kësaj shoqëria. Por, narrativat e tyre dhe aktivitetet e tyre ndër vite kanë terrorizuar këtë vend pikërisht duke e polarizuar edhe krejt shoqërinë në emër të kësaj.

Ndërkohë që i kanë mashtruar qytetarët, sot i shohim në dritën e vërtetë. E vërteta është që sot këta negociojnë me kriminelë. E negociojnë drejtësinë me kriminelë. Paramendojeni, drejtësinë, gjykatësit i negociojnë me kriminelët. E negociojnë dinjitetin e veteranit të UÇK-së me kriminelë, e negociojnë mirëqenien dhe të ardhmen e qytetarëve të Kosovës me kriminelë. Ky është dallimi thelbësor për të cilin po flasim sot.

Pra, zyrtarisht këta nuk bashkëpunojnë me Listën serbe apo me serbët në përgjithësi në mënyrë institucionale, por privatisht në biseda nëpër zyra e nëpër kafene, e kudo qoftë, koordinohen me ta përmes një krimineli. Ky është dallimi.

Dje i dëgjuam duke moralizuar në emër të së kaluarës. Në fakt, këtu s'ka vend për moralizim fare, sepse këto akte tash e tutje do të duhej të shfrytëzoheshin nga organet e rendit, si fyerje dhe shkelje e rendit kushtetues dhe ligjor të Kosovës dhe cenim i sigurisë së Kosovës.

Ndërsa, moralisht, nga kjo foltore ju them që Albin Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje kanë nënshtruar qytetarët e Kosovës duke premtuar shpresë e zhvillim. Kanë mashtruar aleatët e Kosovës, duke premtuar dialogim dhe integrim. Kanë mashtruar e pezmatuar rininë e Kosovës,

duke premtuar edukim dhe punësim. Na kanë mashtruar edhe neve, dhe e kanë turpëruar Kuvendin e Kosovës.

Por, mashtrues do të mbeten në historinë politike të Kosovës. Mashtrues me emër dhe mbiemër, Albin Kurti dhe Lëvizja Vetëvendosje.

KRYESUESI: Tash do t'i ftoj deputetët sipas radhës së paraqitjes.

Nga LDK-ja është Armend Zemaj.

ARMEND ZEMAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë të pranishëm,

Media e qytetarë të Republikës së Kosovës,

Në përvojën tonë politike edhe të përfaqësimit të qytetarëve të Republikës së Kosovës në këtë Kuvend, ndoshta ky është një nga ato momentet kur e ke të vështirë të pranosh faktin se në sallën ku e ndan me të tjerët, Kuvendi përfaqësohet, dhe ku je si përfaqësues i qytetarëve të Republikës së Kosovës, ta ndash me një politikan dhe me një parti që paturpësisht hyn në aventura antikombëtare, siç ka bërë Lëvizja Vetëvendosje dhe shefja e grupit të tyre parlamentar.

Dakordimi me personin me fletarrestim të lëshuar për aktivitete kriminale, i përfshirë edhe në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, dakordimi për tema të brendshme, është pa dyshim tradhti. Prandaj, skema është e qartë. S'kemi nevojë as për fjalime të gjata, thjesht është një njollë e zezë e Lëvizjes Vetëvendosje që do ta bartë me turp në historinë e saj si parti, për bisedat me kryeterroristin, jo të cilat i keni zhvilluar nga prizmi partiak, por nga pozitat shtetërore. Andaj, dëmi është më i madh, sepse keni implikuar shtetin, e keni implikuar Republikën e Kosovës në një veprim tepër të rrezikshëm, tepër të ulët dhe tepër antikombëtar.

Para mediave në Kuvend, me qytetarë, e kudo, Lëvizja Vetëvendosje dhe aktorët e saj paraqiten patriotë të zjarrtë, ndërsa në skuta duke u koordinuar me ata të cilët janë shkelës të ligjit, ata të cilët janë kundër Republikës së Kosovës.

Qytetari i Kosovës këtë kurrë nuk do t'ua harrojë, as nuk do t'jua falë, sepse i keni mashtruar. Para tyre jeni paraqitur diçka që nuk jeni në realitet, e ne ju kemi njohur mirë. sado që të bërtitni, e të ulërin, kot e keni. Jeni koordinuar me një terrorist, këtu mbaron tregimi, sepse siç thotë populli, “jeni zënë me pelë për dore”.

Sot, ju nuk jeni këtu, te vendi ku ju ka dërguar qytetari, sepse këtu nuk mund të mashtroni. Po të ishit këtu, detyrimisht do të duhej të distancoheshit. Këtë nuk mund ta bëni. E para, keni frikën se zonja në fjalë do ta tregojë gjithë të vërtetën, e kur ta tregojë gjithë të vërtetën rreth këtyre negociimeve, atëherë ku do të mbeten ju? Albini nuk ju lë juve e as atë të distancoheni, se ka tema të tjera të cilat duhet të zbulohen.

Mua si deputet i këtij Kuvendi nuk më mbetet asgjë tjetër, edhe në aspektin institucional, edhe të përfaqësimit, edhe si ligjvënës, edhe si mbikëqyrës i këtij ekzekutivi. Kërkoj hetim të pavarur, transparencë të plotë, të zbardhen motivet dhe pasojat e këtyre koordinimeve, e të ketë përgjegjësi politike edhe morale. Kësaj nuk mund t'i shpëtoni! Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti deputet. Tash, fjalën e ka deputeti Pal Lekaj.

PAL LEKAJ: I nderuar kryesues i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Media,

Fjalja ime e parë është: Kolegë të Vetëvendosjes, ku jeni fshehur, dilni prej birucës! Sepse, nuk mbrohet kështu veprimi juaj që e keni bërë. Vetëvendosja ka ardhur me një fletushkë të manifestit të Partisë Komuniste që e ka paraqitur programin qeveritar dhe për këto katër vjet, nuk ka qytetar që e gjen një të mirë që e kanë bërë për këtë vend.

Kanë ardhur me pompozitet për patriotizëm. Kanë ardhur me një entuziazëm të paparë, sepse janë mbështetur prej 50% të qytetarëve. Dhe, pas 4 vitesh, ata po shkojnë me kokën ulur. Nuk kanë bërë asnjë veprim në asnjë segment që qytetari do ta mbajë në mendje.

Nuk kanë bërë veprime të duhura as në arsim, as në shëndetësi, as në mirëqenie sociale, as në infrastrukturë, as në diplomaci, përkundrazi e kanë çuar vendin në humnerë.

Prandaj, mund t'u themi kolegëve tanë nga Vetëvendosja, ejani dhe ballafaqohuni me atë që keni vepruar që asnjë qytetar nuk do të mendonte që ju do të komunikoni me terroristin Radojçiq. Është e pakuptimtë, një lider që vjen nën petkun e patriotizmit dhe i veshur kuqezi, tani pas 4 vjetësh do të shkojë me petkun lara-lara.

Kjo është ajo filozofia e Vetëvendosjes, e mashtrimit. Kjo është politika e tyre turpëruese dhe ne me të drejtë i themi Mimosës që nuk i ke fajet ti, po fajet i ka kryeministri dhe kryetari i Vetëvendosjes, meqë me urdhra të tij ke vepruar. Fajet i ka Dejona që në komunikimin të vazhdueshëm keni qenë me të, dhe ju ka premtuar që do të keni mbështetje. Ku janë fshehur? Ku jeni sot që ta mbron Mimosën? Nuk keni të drejtë, sepse e keni bërë një gabim që historia nuk do t'ju falë.

Nuk do t'ju falë historia, sepse ju keni ardhur që nuk do të uleni në dialog pa i pasur të pagjeturit, pa i bërë të ditur të gjithë ata që kanë humbur gjatë luftës. Dhe, ju jeni ulur këmbëkryq me Vuçiqin. Prandaj, mund t'u themi qytetarëve se sot me plot të drejtë kemi pasur të drejtë kur kemi thënë ditët e para, kryeministri është mashtrues. Ju ka mashtruar dhe për katër vjet ju ka mashtruar dhe do t'ju mashtrojë për jetë e mot nëse i besoni.

Sepse me këtë e ka dëshmuar, jo që i do qytetarët, por e do pozitën. E do karrigen. Dhe, në këtë drejtim, mund të them që ka ardhur koha që ju të mendoni ndryshe, qytetarë të Republikës së Kosovës. Të mos e votoni më një mashtrues që quhet Albin Kurti. Të mos e votoni më një njëri që krejt politikën ia udhëheq Dejona Mihali.

Në këtë drejtim, mund të themi që ne deputetët e zgjedhur çdoherë duhet të jemi në nivel të detyrës dhe në nivel të asaj që quhet Kosovë, dhe që qytetarët kërkojnë prej nesh që të mos i mashtrojmë, të mos i tradhtojmë dhe të punojmë për të mirën e vendit.

Sot, ku është Kosova? A është më mirë sot, apo para katër vjetësh? Mund të them lirisht që sot Kosova numëron ditët më të këqija të mundshme nga këta politikanë. Nga kryeministri Kurti, që e kemi quajtur me të drejtë çdo ministër praktikantë. Praktikantë kanë ardhur. Praktikantë po shkojnë, dhe po shkojnë me histori si tradhtarë të Kosovës, sepse kanë tradhtuar, kanë mashtruar dhe në këtë drejtim i lutim organet që janë përgjegjëse që të shkojnë deri në fund dhe e drejta të dalë në shesh.

Prapë po e them, nuk i ka fajet Mimoza, fajet i ka kryeministri i Kosovës së bashku me Dejonën. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Haki Abazi.

HAKI ABAZI: Faleminderit, zoti Hoxhaj!

Më vjen keq që kolegu yt, kryetari i Parlamentit dje fshihej prapa procedurave. Tha, nuk mund të debatojmë, sepse është çështje procedurash. Nuk thoshte që ishte e parëndësishme, ose nuk ka vlerë një debat i tillë, por thoshte që nuk janë procedurat në rregull.

Ja që u bënë procedurat. E thirrëm seancën. Mendoj është përbrenda demokracisë parlamentare që kur ka arsye, deputetët mbledhin nënshkrimet dhe mbahet seancë.

Tani, mua më bie një peshë pak më e rëndë sot, besoj për shkak se unë kam qenë pjesë e këtij grupi parlamentar që nuk ekziston. E fatkeqësisht janë dy grupe parlamentare që s'janë të pranishme këtu: Lista serbe dhe Lëvizja Vetëvendosje.

Nuk është vetëm simbolikë kjo punë. Dhe, ka arsye se pse jam duke e filluar diskutimin tim para qytetarëve, e deputetëve, mediave pikërisht në këtë mënyrë. Sepse mendoj që para zgjedhjeve të ardhshme duhet të dekonstruktohet çështja e koordinimit me Listën serbe, koordinimit me Radojçiqin dhe tentimin që të shpallet fitore se çka ka ndodhur me veriun e Kosovës.

Unë mendoj që e kemi obligim si përfaqësuese të popullit, të qytetarëve, të votës, të shqiptarëve kryesisht në Kosovë, të zbërthejmë deri në fund që bisedat e Mimoza Kusarit janë taktikat e

Albin Kurtit që ta mbërrijë tensionimin e mjaftueshëm që ta manipulojë qytetarin për atë se çka ka ndodhur në veri.

Do të thotë, nuk ka dilemë këtu për mungesë të fakteve se si është koordinuar e gjithë puna me Listën serbe dhe çka ka ndodhur në veri. Çka ka ndodhur në fakt në veri, është pikërisht ajo që është bërë në pazaret jashtë-institucionale që i ka bërë nëpërmjet Mimoza Kusarit vetë Kurti për të arritur ujdinë e implementimit të marrëveshjeve të arritura nga ana e Vuçiqit në veri dhe, në anën tjetër, izolimin e plotë të Kosovës nga bashkësia ndërkombëtare.

Domethënë, kjo është korniza brenda së cilës ne po flasim dhe pse quhet kjo punë tradhti kombëtare. Sepse duke tentuar që të mblidhen poenë politike janë shitur interesat e vendit. Sigurisht që aspekti emocional, sentiment i tjetër ka të bëjë me çështjen që paturpësia mbërrin deri në limitin e përjashtimit të veteranëve nga skemat. Por, kjo nuk përfundon këtu. Këtu dëmi është shumë i thellë për shkak se nëpërmjet manipulimit së pari të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, e cila ka ndodhur si manipulim në vazhdimësi, të nderuar qytetarë.

Domethënë, ka pasur arsye pse Kurti nuk ka dashur të jem kryetar i Komisionit për Punë të Jashtme. Nuk ka dashur të jem as pjesë e diskutimeve të brendshme, sepse kam qenë i vetmi në grupin parlamentar që në çdo takim kam tentuar ta zbërthej manipulimin dhe orkestrimin e çështjeve për të cilat po flasim sot. Dhe, kjo punë i ka tre vjet. Nuk është dje.

Të jeni të bindur që do ta bëja në secilën situatë. Kjo është arsyeja pse as nuk kanë guxim të ballafaqohen. Sot janë në betejën e humbur, sepse çfarë do t'i thoshin publikut. Cili do të ishte argumenti më i fortë, i cili do të dilte dhe do të thoshte që nuk është bërë manipulim i Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje për 4 vjet radhazi. Kjo është maja e ajsbergut, sepse gënjeshtria për kandidatin për Gjykatën Kushtetuese ka qenë gënjeshtër prapë e një manipulimi të thellë, të cilin e kam diskutuar hapur me kryeministrin Kurti, se pse ka ndodhur që të eliminohen njerëzit profesionistë prej listës së kandidatëve për anëtarë të Gjykatës Kushtetuese dhe janë futur njerëzit të cilët janë të afërt me Mimoza Kusarin dhe pazaret politike të partive politike.

Do të thotë, interesi nuk ka qenë shkapja e shtetit. Nuk ka qenë pavarësia e gjyqësorit. Nuk ka qenë pavarësia e Gjykatës Kushtetuese. Ka qenë ndikimi i plotë mbi Gjykatën Kushtetuese. Dhe kjo, rrjedhimisht, na sjell në momentin tjetër që është shumë i rëndësishëm, e unë ju bëj lutje kushdo që është sot e kushdo që do të jetë në të ardhmen në këtë Parlament, është që idenë komuniste, idenë sllavo-komuniste të formimit të Byrosë për Konfiskimin e Pasurive, që tingëllon sikur gjë e një moraliteti të lartë politik, është instrumenti më i rrezikshëm i mundshëm që mund ta ketë një instrument politik, qoftë edhe kryeministri në duart e tij.

Kjo ka qenë prapë arsye që unë kam votuar kundër formimit të Byrosë, sepse është tentimi për ta shantazhuar secilin që është në pjesën e vendimmarrjes në politikën e vendit tonë.

Po them që është maja e ajsbergut, sepse nuk kemi se çfarë në fakt ta godasim këtë çështjen e Radojçiqit më tutje. Slavko Simiq ka hyrë në zyrat e Lëvizjes Vetëvendosje, të Grupit Parlamentar, pa e ditur asnjë deputet tjetër, e as Gani Krasniqi, e as Salih Zyba.

Manipulimi nuk është vetëm për veteranët, manipulimi është edhe për të zgjedhurit, të cilët e kanë dhënë besën në fushata elektorale që do e bëjnë ndryshe. Por, në një qeveri kur ministrja me një rresht në e-mail kërkon 200 mijë litra vaj, ndërsa ministri tjetër nuk e di se çka do të hajë në mbrëmje, në mëngjes ose për drekë ushtria jonë, i bie që faktikisht ne jemi para një krize të menaxhimit të plotë të çështjeve të rëndësishme vitale të shtetit.

Dikur flisnin për sekret shtetëror, sot në e-mail shihet që ministrja i kërkon 200 mijë litra vaj për rezervën shtetërore. Kaq fëmijërore, kaq naive është çështja e menaxhimit të shtetit tonë sot. Dhe, kjo vërtet e bën të rrezikshme që të bën të ndihesh gati mirë kur s'janë këtu, sepse janë parrezikshëm kur nuk janë këtu.

Edhe nuk po bëhem, kështu të tentoj të jenë lojë fjalësh, por vërtet mendoj që janë të rrezikshëm, sepse kur e ke një shumicë kaq të madhe parlamentare totalisht të heshtur, sepse një deputet e mbron interesin e vet për linjat e aeroplanëve, tjetri deputet e mbron interesin e hapjes së pompave të benzinës, tjetri bën firma e kompani për ndërtim, do të thotë Lëvizja Vetëvendosje është kthyer në një grup interesi homogjen nga njerëz heterogjenë, të cilët ishin bërë bashkë për ta bërë transformimin e madh të konceptit qeverisës.

Dhe sot ikin nga debati të gjithë, edhe ata profesorë universitarë që do të duhej të ishin me kurriz sot këtu, që paturpshëm me siguri u ligjërojnë studentëve të tyre se si guximi qytetar është i domosdoshëm për demokracinë. Sot nuk janë këtu. Nuk guxojnë të ballafaqohen me argumentin dhe me debatin demokratik.

Nuk guxojnë as të shtrojnë pyetje në asnjë rrethanë, përveçse ta përcjellin fjalën e autokratit, i cili realisht po duket që të gjitha kauzat politike në opozitë i ka pasur për një qëllim të vetëm, ardhjen në pushtet dhe abortimin e demokracisë në Kosovë. Ky nuk mund të quhet tjetër, kur merr guxim shefja e grupit parlamentar të flasë në mënyrë joinstitucionale, të bëjë pazare me Listën serbe për veteranët, i bie që këtu demokraci nuk ka.

Nuk ka mekanizëm llogaridhënës. Nuk ka mekanizëm të përgjegjësisë e të përgjegjshmërisë për ata që janë të mveshur me pushtet politik dhe me fuqi vendimmarrëse.

Tani, sigurisht do të kemi nevojë që debatin ta orientojmë në drejtim të asaj se çfarë do të thotë kjo për të ardhmen. Unë mendoj që, më vjen keq që është grua, sepse e di që e kanë shkruar edhe një postim aty kinse unë paskam diçka kundër Grupit të Grave.

Në jetën time profesionale për 25 vjet, në fakt jam përkrahësi më i madh në fuqizimin e rolit të gruas në të gjitha shoqëritë ku kam punuar. Por, tentimi për mvëshur e për ta lëshuar milicinë e Facebook-ut, për të degraduar njerëzit politikisht, është profesion i një milicie që udhëhiqet nga komandanti Kurti.

E po e them prapë, më vjen keq që është grua, por pas krejt kësaj trajektoreje të lëvizjes të përfitimeve prej kartelave të Behgjet Pacollit për ndërtimin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Regjia, ia zgjat edhe një minutë fjalën!

HAKI ABAZI: Ky sistemi i Luksemburgut po duket më i ngadalshëm. Mendoj që ka ardhur momenti që deputeti duhet ta ketë një standard. Deputeti, deputetja duhet të ketë një nivel. Nuk mund çdokush të bëjë udhëtime e të vallëzojë në secilën dasmë dhe prapë të jetë me përgjegjësi të mvëshur për çështje kritike të interesit publik shtetëror, e aq më tepër kur preken edhe interesat e sigurisë kombëtare në këtë rast.

Kështu që, po, kërkesa në rezolutë është e arsyeshme. Ne duhet, kjo legjislaturë duhet të përcaktojë standard se kush mund të jetë i veshur me pushtetin e deputetit. Me përgjegjësinë e deputetit. Me obligimet e deputetit. Dhe, jo çdokush duhet ta mbajë këtë nder dhe këtë besë ndaj qytetarëve. Faleminderit!

KRYESUESI: Zoti Ardian Kastrati e ka fjalën.

ARDIAN KASTRATI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar, profesor Hoxhaj!

Dje dëgjova që qenka një ministër këtu, se kishte harruar që është ministër pa e parë kurrë në Kuvend, edhe pa e parë as në televizor, paska thënë që ato janë inteligjencë artificiale.

Unë jo për shou, por e kam që ta dokumentojë perversitetin politik të Mimit, e kam bërë edhe unë një me inteligjencë artificiale, e shkurtër keni durim!

(Deputeti lëshon audio-incizime nga telefoni i tij i mençur në mikrofonin e foltores)

Pra, a e kuptoni, do të thotë nuk është çështja e aktit që e ka bërë kjo Mimoza Kusari, edhe dikush mund ta quajë tradhti, dikush ta cilësojë ashtu, ose kështu. Mua më impresionon persiviteti politik i saj që e demonstroi dje në mënyrën më patetike këtu në Kuvend.

E thanë edhe kolegët, do të thotë, kjo dihet që është bërë me urdhër e koordinim nga Albin Kurti.

Kjo doli tha dje që, jo ne s'kemi folur me Radojçiqin, por ju jeni bashkëpunëtorët, ju jeni tradhtarët. A e kupton! Do të thotë, sikur puna kur e sheh atë trenin e shpejtë duke kaluar edhe i thua Mimosës, shiko treni i shpejtë po kalon, ajo thotë, jo more është një avokado fluturuese.

Ia bën një foto dhe i thua, jo bre se treni është, thotë, jo bre s'po dike të bësh përpunim artistik, s'paske lidhje me art modern. Pra, Radojçiqi me ftesë të Mimosës në Kuvend, Radojçiqi e çon dorën që t'i heqë veteranët e luftës nga ligji, kurse ne jemi bashkëpunëtorët.

Pra, kjo gruaja i ka bërë një shërbim të jashtëzakonshëm shtetit serb, dhe akti i shërbimit mua nuk më intereson nga cili motiv i saj vjen. Ka predispozita që t'i shërbejë Serbisë. Nuk e di, vjen prej budallallëkut, nuk e di, vjen prej paaftësisë së saj nuk e di, por shërbimi dje është kryer dhe dje ia mësova unë emrin perversitetit politik që ishte barazi me Mimoza Kusarin.

Shikoni, unë mbeta i befasuar, këtë pjesë dua ta diskutoj me narrativen e saj dje, të mohimit dhe të absurdizimit të situatës me përdorimin e fjalëve që janë shprehje diçka komplet të kundërt me audion që krejt ne njerëzit e gjallë këtu e dëgjonim që ka folur me Radojçiqin. Pra, kjo u bë një arkitekthe e një realiteti të vet, e një situatë të vet të caktuar, e cila ishte plot me elemente dekorative të një narracioni të paqëndrueshëm, është narracion i paqëndrueshëm, sepse 100 veta po e shohin që ke folur me Radojçiqin dhe vetëm ajo po e sheh një situatë tjetër dhe kjo natyrisht që bëhet qëllimisht.

Prandaj, unë mendoj që edhe dje, megjithëse çka u tha nga opozita nuk manifestohen mjaftueshëm qëndrimin tonë përballë këtij relativizimi që i bëri ajo situatës dhe madje përballë sulmit që na bëri ajo neve. Unë shpresoj që në të ardhmen do të tregoheni shumë më të ashpër për faktin se kështu duke qëndruar pak a shumë si butësisht, pastaj këta po krijojnë këso narracione dekorative 20-vjeçare shkatërrim, 20-vjeçari hajna, 20vjeçari me Radojçiqin. Mimi dje ishte në kanalizim deri në fyt dhe me buzëqeshje të gjerë i thoshte qytetarit “jo, asgjë s'ka ndodhur, çdo është në rregull, besomëni, ky është një eksperiment për menaxhim krizash”. Por, ajo e krijoi dje një imazh të një politikaneje qesharake që refuzonte të pranojë edhe veprimin, edhe pasojat e gabimeve të saj, edhe unë mendoj që prej dje kemi pasur një karakter të paharrueshëm në skenën tonë politike që do t'ia kishin lakmi edhe ata aktorët hollivudianë, bile nuk e di se kush kishte mundur të interpretojë rolin më shumë, më mirë, s'po di a Meril Strip apo s'di kush i kish shkuar për shtati më shumë.

Pra, t'u qitësh hi syve dhe qytetarëve, pavarësisht që dëmi ka qenë i jashtëzakonshëm, se siguria nacionale është rrezikuar jashtëzakonisht dje, për këtë ekspertët e dinë më mirë se unë. Por, kjo është shkolla e Albinit, e thanë kolegët, kjo është shkolla e Albinit, i thonë ata njerëzit racionalë afër Vetëvendosjes: “Shiko, shef, se keq me Amerikën, shiko se sanksione, shiko se e ke katandisur popullin në fukarallëk, shiko se 6,80 euro po i rrit rrogat, nuk janë punët mirë dhe ai thotë: “Jo, shikoni, ju nuk gjendje t'i kuptoni reformat e mia madhështore, ju nuk keni vizion,

sepse ju nuk po keni mundësi t'i braktisni shprehitë e regjimeve të kaluara". Dhe, njerëzit i hapin sytë dhe pyesin, thonë, "ku janë bre këto rezultate, vëlla i dashur", a po kupton. Si t'i thuash dikujt "hajde notojmë në pishinë pa ujë, e mësohemi të notojmë në zall". Edhe nja 2-3 ditë mundohesh dhe dikur kur thahesh, Albini prapë të thotë ty "shiko, dini me notua në zall, po s'po provoni". Ai vazhdon të mburret me metodat revolucionare, përderisa njerëzit presin ujin në pishinë për t'u larë.

Pra, është një botë iluzione që ka krijuar Albin Kurti, plot mashtrime, është një botë të cilën ne si obligim, si opozitë, qytetarë, si patriotë të këtij vendi, krejt bashkë, të tria këtu çka jemi, e kemi obligim për ta rrëzuar, për ta zhbërë. Pra, është përtej partisë politike, përtej fitimit të pushtetit. Kurti vazhdon ta ekspozojë vendin me rreziqe komplekse shumëdrejtimëshe në arenën ndërkombëtare dhe besoni që kjo kriza diplomatike që ka shkaktuar në arenën ndërkombëtare nuk është vetëm izolim ndërkombëtar, por ky izolimi ndërkombëtar përbën kërcënim ekzistencial për sigurinë nacionale dhe stabilitetin afatgjatë të Republikës së Kosovës. Kjo qasje e Kurtit, e dini të gjithë këtu, e ka degraduar shumë pozicionin e Kosovës, në konstelacionin e ri gjeopolitik, rajonal duke e marginalizuar fare atje në qosh. Bile na ngjan ngjashëm me disa kësi profesorë marksistë Salvador Alende, të Kilit, e disa liderëve përpara, Nigeri e Bolivi, që e dinë se si kanë përfunduar dhe nëse vazhdon kështu, unë jam i bindur që ne s'do të kemi aftësi ta mbrojmë sovranitetin dhe integritetin territorial të kësaj republike.

Sanksionet nuk janë thjesht një manifestim i mosmarrëveshjeve me Kosovën me Albin Kurtin. Ato janë sinjale të zhgënjimit të thellë të aleatëve tanë, jo me Kurtin, por edhe me Kosovën kësaj radhe, sepse Kurti e përfaqëson Kosovën. Prandaj, Kurti qëllimisht ka prodhuar një polarizim të jashtëzakonshëm, të tmerrshëm shoqëror që kjo shoqëri të mos mund ta shohë rrugën e re të ekuilibrit të ri gjeopolitik që Kurti po i hap në Ballkan. Dhe, ky ekuilibër i ri gjeopolitik po e avantazhon Serbinë, e keni parë marrëveshjen me litiumin. Në vitin 2000 Gjermania ka prodhuar 5 milionë vetura, sot i prodhon 4 milionë vetura, 1 milion më pak ajo ekonomi. Kina atëherë ka prodhuar 600 mijë vetura, sot i prodhon 24 milionë, dhe Serbia është ajo që hyn në mes me litium për t'i bërë këto balanca, kurse këta rrinë duke ngrënë keksa te Misini e Hebsi atje në Veri. A po e kuptoni se si hedhin hi syve popullit, përderisa ekuilibri i forcave të reja gjeopolitike në rajon veç ka filluar të krijohet, të mos flas për ushtrimet e Serbisë ushtarake me SHBA-në, Mali i Zi milionë turistë, Shqipëria milionë turistë, 20 milionë udhëtarë Aeroporti i Tiranës, e ne rrimë këtu edhe hamë fara.

Pra, ne të gjithë e dimë që ka një paradoks të madh ndërmjet diskursit patriotik dhe veprimeve konkrete të Albin Kurtit, të cilat efektivisht e legjitimojnë interesin e Serbisë në Kosovë. Ky e ka përdorur kinse shtrirjen e sovranitetit atje, si flamur që tundet kështu nëpër erë krejt kot, a ne po e shohim që këto erërat ndërkombëtare çdo ditë e më ftohtë po fryjnë në drejtim të Kosovës, e në drejtim të shtetit tonë të vogël. Jam i bindur thellësisht, e kam përsëritur nëpër krejt studiot televizive, që nga Garashanini deri te Qosiqi lakmi ia kishin pasur se si një shqiptar për katër vjet

mund ta shkatërrojë e ta dëmtojë kaq shumë Kosovën, sa s'ka mundur Serbia për 150 vjet, sepse i kanë vënë sanksione, i ka prishur marrëdhëniet me SHBA-në, sepse i ka prishur marrëdhëniet për toke ato relacionet ndërshtetërore dhe e ka katandisur popullin në fukarallëk dhe e ka futur në sanksione.

Dhe, jo vetëm këto, ne vazhdimisht dhe pa u ndalur, 24 orë, çdo minutë, çdo sekondë duhet t'ia përmendim që ke rrejtur, se ke thënë do ta liroj rrymën, e ke bërë 100% më shtrenjtë, sepse ke rrejtur, ke thënë do ta zbusë TVSH-në për vaj, sheqer, mallra, e ke shtrenjtuar vajin, sheqerin edhe mallrat. Sepse i ke përmbi 2 mijë kontrata, që i ka publikuar, njëburimore, prej të cilave 1 mijë e 300 e kusur janë për herë të parë. Pra, janë korrupsion në nivel mafioziteti me Martinin, me KEK-un, me Nagipin e tjera. Dhe në fund u ke jep 6.80 centë rritje qytetarëve, 7 mijë e 500 euro Gani Jakupit, 13 mijë e 200 qytetarë nëse i kanë marrë nga 6 euro e 80 centë, bëjnë 90 mijë euro, veç Gani Jakupi veç vetë i ka marrë 90 mijë euro.

Ky është poshtërimi më i madh që në fund Albin Kurti, përveç politikave të jashtme që i potencova dhe menaxhimit të krizave me Mimosën, ia bënë këtij vendi. Ne e kemi për obligim e tani është situata, momenti që ta këpusim këtë zinxhir të keqeverisjes së kriminalizuar, i cili na ka futur në një rreth vicioz të zhgënjimeve të hatashme, të tradhtive dhe të...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ia zgjatni edhe një minutë që ta përmbyllë fjalën.

ARDIAN KASTRATI: Unë e di që nuk është lehtë, sepse ky një pjesë të njerëzve i ka bindur që mund të notojnë në pishinë me zall dhe pa ujë, dhe e di që është e vështirë, por unë mendoj që e kemi obligim, sepse për ata veteranë që u diskutua këtu, janë ata forca e shpirtit, të cilëve, forca e shpirtit të pamposhturve të cilëve e kanë ndërtuar këtë vend, sepse janë lëvizjet politike të këtij vendi, ndër dekada, për liri e pavarësi, sepse është dëshira e madhe e këtyre qytetarëve ta duan këtë vend, e mbi të gjitha është miqësia jonë me ata aleatë, të cilët na kanë ndihmuar neve të çlirohemi, e ne e kemi për obligim këtë njeri ta heqim. Këto përpjekje madje nuk kanë kufi historik, shkojnë deri atje te Vilajeti i Kosovës. Ne duhet, mendoj të bëhemi bashkë më shumë se kurrë që frontin anti-Albin që unë po e shoh që është shumë i madh, ta kthejmë në front proopozitar, sa më shumë dhe sa më gjerë. Besoni që në këtë sens kushdo që asociohet dhe do të asociohet brenda dhe jashtë këtij Parlamenti me Albin Kurtin...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Vazhdojani një minutë!

ARDIAN KASTRATI: Kushdo brenda dhe jashtë këtij Parlamenti që do të asociosohet me Albin Kurtin në të ardhmen e afërt, se koalicion s'po ma zë goja të përmend, besoni se do ta vulosë aktin e madh që Albin Kurti është duke e bërë kundër vullnetit të aspiratave të larta të këtij shteti, e që shkon deri në vetëshkatërrim kombëtar. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga Lidhja Demokratike e Kosovës ftoj zonjën Bajrami.

HYKMETE BAJRAMI: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Përshëndetje gjithashtu për shumicën parlamentare, të cilët sot edhe unë jam e sigurt që po na përcjellin prej ekraneve dhe më vjen keq prej një pjese të tyre, të cilët besoj që me dëshirë kishin dashur të jenë prezentë, por e di që nuk i kanë lënë.

Të nderuar kolegë deputetë, unë me shumë ëndje flas për profilin tim ekonomik, për shifrat, për korrupsionin dhe gjërat e tjera, por e ndjeva shumë të nevojshme sot të dal këtu dhe të mundohem në kuadër të kapaciteteve të mia që t'u shpjegoj qytetarëve pse është e rëndësishme që sot ta kemi këtë debat dhe të diskutojmë për këtë temë, pavarësisht problemeve dhe shumë të mëdha ekonomike dhe sociale me të cilët po përballen qytetarët tonë në baza ditore. Duhet ta kemi një gjë të qartë se pse kjo çështje, këto përgjime po mundohen të relativizohen se kinse këto po i bën opozita, po fabrikohen dhe gjëra të tjera. Mirëpo, atë çfarë e kemi sot kristal të qartë për secilin që e ka dëgjuar atë video incizim të shkurtër është që shefja e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, të partisë që i ka fituar 51% të votave në zgjedhjet e fundit, koordinohet me terroristin e quajtur Milan Radojçiq, për të kërkuar votat, për të mbështetur Ligjin për pagën minimale, i cili ligj ka lënë jashtë veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Tani vetëm bisedat telefonike me një terrorist përbën vepër penale në vete, sepse do të ishte e natyrshme që zonja Kusari të koordinohet me njërin prej deputetëve të Grupit Parlamentar, qoftë edhe të Listës serbe për të marrë mbështetjen për një çështje, për një ligj apo për një votim në Kuvend, sepse ata janë kategori kushtetuese, janë këtu kurdo që dëshirojnë të jenë dhe koordinimi nuk do të përbente ndonjë vepër, përpos patriotizmit të rrejshëm që këta janë munduar ta shesin prej fillimit të kësaj legjislature, duke thënë që nuk jemi në koalicion, e në fakt këta jo vetëm në koalicion, por në pazaret e përditshme. Tani ajo çfarë kemi dëgjuar është që zonja Kusari, domethënë si shefe e Grupit Parlamentar, kur bisedon me Radojçiqin, bisedon në telefonin e Simiqit e kemi thënë edhe dje e tha dikush nga kolegët deputetë, pse e bën këtë? Sepse është e ndaluar që një zyrtar i Qeverisë së Republikës së Kosovës të diskutojë me kriminelin, domethënë këtë ajo e ka bërë në mënyrë të vetëdijshme.

Dhe, çka dëgjohej aty? Dëgjohej duke i thënë që na nevojiten votat dhe Radojçiqi i thotë që do t'i keni votat, mirëpo unë kam kërkesa për shefin e juaj. Tani kush është shefi? Shefe e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje është Mimoza Kusari, shefi i saj kush është tjetër pos

Albin Kurti dhe çka pajtohet në përgjim, në incizim Mimoza Kusari. Pajtohet që ditët në vijim ta pranojë Simiqin në zyrë për të biseduar për kërkesat e Radojçiqit dhe kjo duhet të hetohet sot. Duhet parë se cilat kanë qenë kërkesat e Radojçiqit për shefin e Mimoza Kusarit, i cili është Albin Kurti, është Kryeministri i Republikës së Kosovës. Sepse ne kemi parë edhe rezultatin e atij koordinimi që ka qenë votimi në Kuvendin e Republikës së Kosovës i Listës serbe për Ligjin për pagën minimale. Domethënë, këtu qëndrojmë, t'i kemi të qarta të gjitha këto dhe kjo është arsyeja pse ne sot kërkojmë hetim.

Ne sot duhet të dimë cila është kostoja që Republika jonë, e katandisur si mos më keq në këto vitet e pasluftës dhe pas pavarësisë në skenën ndërkombëtare, që e ka marrë imazhin e agresorit dhe jo të viktimës, siç e ka pasur, cila është kostoja që Republika jonë e ka paguar si rezultat i këtij koordinimi me terroristin Radojçiq. Gjendja faktike në të cilën ne sot jetojmë, është që Kosova është në masa ndëshkuese të Bashkësisë Evropiane. Derisa Serbia, edhe pas sulmit terrorist në Banjskë, ku ra hero Afrim Bunjaku, ka nënshkruar krejt vonë marrëveshje për blerje të avionëve luftarakë me Francën, me Makronin, në vlerë prej 3 miliardë euro. Kush e solli këtë situatë? Qysh ka mundësi që Kosova 25 vjet pas luftës, pas intervenimit të NATO-s, pas miqësisë së paçmuar me krejt aleatët ndërkombëtarë, sot të jetë në masa ndëshkuese të BE-së, derisa Serbia nënshkruan marrëveshje për blerje të avionëve luftarakë nga Franca. Qysh ka mundësi që derisa ne jemi në masa ndëshkuese të BE-së, serbëve, qytetarëve të katër komunave veriore u pranohen pasaportat ilegale nga Komisioni Evropian.

Nuk janë pranuar kur është hequr kufizimi i vizave Serbisë, nuk u janë pranuar kur është bërë liberalizimi i vizave për Kosovën, mirëpo janë pranuar krejt më vonë pasaportat ilegale. Qysh ka mundësi që Serbia, e cila pas sulmit të Banjskës shkon dhe nënshkruan marrëveshje të partneritetit strategjik për energjinë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës, derisa ne e kemi një kryeministër, i cili që 4 vjet as nuk po arrin t'i afrohet pragut të Shtëpisë së Bardhë. A janë këto kostot? Ne duhet ta pyesim veten a janë këto kostot e koordinimit të politikave të Mimoza Kusarit në emër të shefit të saj, kryeministrit Albin Kurti me terroristin Radojçiq. Sepse, krejt çka kanë bërë politikatat e tyre veç ujin në mulli të Vuçiqit dhe të Serbisë kanë dërguar. Andaj, edhe sot këtu, në emër të Lidhjes Demokratike të Kosovës kërkoj nga organet e drejtësisë që me të vërtetë të bëhet një hetim, të hetohet Mimoza Kusari, e cila ka lejuar të bëhet mashë e Albin Kurtit, mirëpo niveli i parë i përgjegjësisë i takon pikërisht atij, shefit të Mimoza Kusarit, Kryeministrit të Kosovës, Albin Kurtit. Faleminderit!

KRYESUESI: Ftoj nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës zotin Bekë Berisha.

BEKË BERISHA: Të nderuar deputetë,
Qytetarë të Republikës së Kosovës,
Kryesues,

Së pari po u drejtohem këtyre deputetëve këtu që s'do të kenë më mundësinë të vijnë në këtë sallë, e çështjen që po e trajtojmë sot gjithmonë ka pasur njerëz që i kanë shërbyer armikut, domethënë burra e gra, direkt e indirekt e gjithqysh.

Por, pyetjen që po dua t'ua bëj këtyre, deputetëve të pozitës: si arriti një spiune greke t' i bëjë zap një grup parlamentar shqiptar, dhe të mos guxojë kush të ndihet. Kur dal ndonjëherë në terren, e më bie shpesh, njerëzit e kanë fituar bindjen qysh po mund ta duroni Dimal Bashën, thotë ndokush. Po nuk është e vërtetë, nuk është problemi Dimal Basha këtu. Është njëfarë karaqozi, sulmon aty me fjalë, po problemi janë disa të tjerë këtu. E keqja në këtë grup është më e madhe, më e vjetër, më sistematike edhe shumë më e rrezikshme. Në këtë seancë që po e trajtojmë një rast të keq të koordinimit, sinkronizimit, me armikun kundër UÇK-së, që mua nuk më bën përshtypje fare, se jam i bindur dhe e kam ditur këtë, mirëpo po na grumbullohen skandalet aq shumë që veç po i konsumojmë diqysh duke thënë ky është spiun e ai sahi është spiun. Po çka t'i bëjmë ushtrisë, sot e kemi pa bukë? A ta tejkalojmë tash këtë problem që nuk është hiç më i vogël se ky, se sa për kesi spiunësh, t'i njëh edhe nja dhjetë këtu që janë saktë.

Qëllimi tash këtu është të dëmtohet funksionaliteti i ushtrisë, sot komandanti paska thënë “ne refuzojmë t'i kryejmë detyrat si ushtri, nëse nuk zgjidhet problemi i ushqimit”. Pse ka dalë problemi i ushqimit? Po, është çështje korruptive që janë aty dy grupe të pushtetit, duke shikuar kush ta marrë atë tenderin 10 milionë. Tash e dinë në emra këta që duan ta ndërrojnë operatorin, edhe dikush ka bërë marrëveshje me operatorin ekzistues. Ky është problemi i ushtrisë. Po, nuk është veç hajni prapë, është për ta prishur funksionalitetin, të vijmë në këtë situatë ku ushtria nuk është funksionale. Problem tjetër tash që s'guxojmë as këtë ta tejkalojmë. Serbia e ka pushtuar Kosovën ekonomikisht për një ditë, e ka mbushur me kamionë masivisht. Edhe ky është problem që duhet folur këtu, edhe nuk mund këta neve të na detyruar duke u marrë me sa është duke punuar për armikun dikush këtu, që krejt është e qartë, të harrohet edhe ky fakt. Se është video, ka manipuluar. I them Mimoza Kusarit s'ka pasur kohë kush, edhe s'ka nevojë të manipulojë, se ajo është origjinal ashtu, si është, në mos qoftë edhe më zi. Edhe bile hiç s'më bën përshtypje që del edhe më zi.

S'kanë lënë njeri këtu pa e etiketuar, pa e sharë, pa thënë, e duke mos e parë veten, derisa ne i kalonim. Qe kush janë këta!

Nuk duhet harruar një, Albin Kurti e ka përgjegjësinë e organizatorit, e koordinatorit, e mashtruesit, e rrencit, e tradhtarit, e të gjitha këto i koordinon Albin Kurti, qysh tha kryetari Ramushi, ky është duke i larë borxhet e veta. Nuk po dua tash të bëj një komparacion mes Azerbajxhanit dhe Armenisë, paska qenë një rast kështu, edhe kur e pushton Azerbajxhani tash në fund Armeninë që e mori pas një gjenocidi që ka ndodhur aty në popull, ai i kishte pas thënë Turqisë dhe Azerbajxhanit, “e kreu unë detyrën, më s'kam borxhe”. Kam frikë se kjo do të dalë. Faleminderit!

KRYESUESI: Nga Partia Demokratike e Kosovës, z. Bekim Haxhiu.

BEKIM HAXHIU: I nderuar nënkryetar i Kuvendit, zoti Hoxhaj!

Të nderuar kolegë deputetë, të cilët jeni prezentë sot, ftojme në këtë seancë, e cila nuk është e zakonshme, është e jashtëzakonshme, sepse kemi të bëjmë me një seancë të jashtëzakonshme.

Përgjimet e publikuara dëshmojnë se kemi të bëjmë me cenim të rendit kushtetues të Kosovës dhe të sigurisë nacionale të Republikës sonë. Kur përfaqësuesja e shumicës parlamentare të Lëvizjes Vetëvendosje dhe Qeverisë Kurti koordinohen me kryeterroristin Radojçiq, që është i kërkuar nga institucionet e drejtësisë të Kosovës dhe koordinohet për çështje shtetërore të Kosovës dhe të qytetarëve të saj.

Të nderuar kolegë deputetë,

Bini i Binçes, na doli të jetë edhe Bini i Radojçiqit dhe i Vuçiqit. Pra, Albin Kurti u votua për kryeministër, këtu në këtë foltore, i kam kërkuar që të përgjigjet për takimin e tij me përfaqësuesit e BIA-s serbe më 17 janar 2004, kur është takuar me vëllezërit Donçiq, njëri kryeshef i BIA-s dhe tjetri kapiten i ushtrisë serbe, në një fshat të banuar me serbë. Kishte shkuar i mbuluar me batanije, e batanijen e kishte siguruar nga baca Islam, i cili nuk e dinte pse po ia jepte atij dhe djalit të tij Dardan Velisë, e Albin Kurti, për t'ia kthyer këtë shërbim Dardan Velisë, e emëroi edhe kryeshef të ndërmarrjes për menaxhimin e deponive të mbeturinave, po nuk patën guxim më të kthehen kurrë te baca Islam, për t'ia kthyer batanijen, për shkak se e dinin që atje nuk ka mbajtur një takim për interesin e Kosovës, porse pas atij takimi të Binçes, fillon edhe rebelimi i Kurtit, sepse deri atëherë ishte me KAN. Ishte pro integritetit të serbëve, pro UNMIK-ut. Aty fillon rebelimi i Kurtit dhe në marsin e atij viti i kemi edhe trazirat e marsit, e të cilat i udhëhoqi BIA. Ishin në dëm të Kosovës, e që ishte parapërgatitje e BIA-s para negociatave të Vjenës, ku Serbia kërkoj hisen e saj në çështje të Kosovës për të mbrojtur kishat, të cilat u dogjën gjatë trazirave të marsit.

Kishte kërkesë që të ktheheshin policë serbë në Kosovë për t'i mbrojtur kishat serbe. Kërkesën e kishin nënshkruar dy përfaqësues të organizatë Bozhur, e të cilët kishin qenë në takim me Kurtin, vëllezërit Donçiq. A është rastësi kjo?

Të nderuar kolegë deputetë,

Kemi të bëjmë me dëmtim të interesit shtetëror të Kosovës dhe kur ky koordinim shkon deri aty sa një deputete e Kuvendit të Kosovës dhe udhëheqësja e shumicës parlamentare të Lëvizjes Vetëvendosje, e deleguara e Kurtit, e merr mbështetjen e listës serbe për të votuar gjykatësit e Gjykatës Kushtetuese, për të votuar kundër, për të votuar Ligjin e pagës minimale që i eliminon veteranët e Ushtrisë Çlirimtare nga paga minimale, i eliminon të verbrit nga paga minimale, i eliminon paraplegjikët e tetraplegjikët nga paga minimale. Për të votuar kundër tash Projektligjit për Trustin, që ishte iniciativë e qytetarëve në kohë krize.

A ju kujtohet se çfarë i kishte thënë Mimoza Kusari-Lila përfaqësuesit të Listës serbe: “Mos e votoni këtë Projektligj për Trustin, se iniciativën po e udhëheq Bekim Haxhiu”. A ju kujtohet se si dëgjohet në përgjim duke i thënë: A e di kush është Kamishi? Kujt po i thotë? A e di kush është Kamishi? Është një pseudonim i luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, një ushtari të plagosur, bashkëluftëtarit të Adem e Hamzë Jasharit, bashkëluftëtarit të Hashim Thaçit e Kadri Veselit, të Jakup Krasniqit e Rexhep Selimit, e ajo po i thotë: A di kush është ai? Qysh jam unë ta përkrah. Pra, deri këtu shkon niveli i poshtërsisë politike, i hipokrizisë politike, për të cilat kishte vendosur kushte Radojçiqi.

Prandaj, e jona sot si Kuvend dhe si përfaqësues të qytetarëve sot nuk është për të kërkuar llogari nga Mimoza Kusari vetëm për atë takim, por për të kërkuar cilat janë kushtet e Radojçiqit për votën pro gjykatësve të Gjykatës Kushtetuese, për votën pro Ligjin për pagën minimale që i eliminon veteranët dhe për votën kundër Projektligjit për Trustin, të cilin e siguroi Mimoza Kusari për Albin Kurtin dhe cilat janë kushtet e Radojçiqit? A ka logjikë që 25 vjet pas luftës të ndodhin gjëra të tilla në Kosovë?

Si është e mundur që prej vitit 1999, kur përfundimisht Serbia u përzu nga Kosova falë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ndërhyrjes së NATO-s, të na kthehet çizmjja e Serbisë në Kosovë, e uniformuar, e motorizuar, e armatosur deri në dhëmbë dhe e vret policin e Kosovës dhe lejohet Radojçiqi këmbë pas këmbë të kthehet në Serbi dhe ta marrë mbrojtjen e Vuçiqit.

Pyetja logjike është: A kishte koordinim dhe a ishte ky kushti i Radojçiqit për Kurtin për veprimet e tij në Binçë?

A ka ndikuar Kurti brenda kësaj periudhe kohore në këtë koordinim prej se ka ardhur në Qeveri ta përmirësojë imazhin e Serbisë në botë? Po! A ju kujtohet në kohën e COVID, kur Kurti pranoi donacion testet Covid nga Serbia, teste të cilat ishin prodhim rus dhe nuk u përdorën asnjëherë në Kosovë, por patën efekt në mediat ndërkombëtare për përmirësimin e imazhit të Vuçiqit, i cili po i jep donacion Kosovës. Pra, ai i cili na kishte vrarë dhe ishte zëdhënës i Milosheviqit, tash po bëhet i mirë në votë, se po jep donacion ta shpëtojë popullin e Kosovës dhe u lejua që mjekët serbë të vijnë e të punojnë në Kosovë pa licencë të Kosovës dhe kjo u prezantua si një akt humanitar i mjekëve të Serbisë për Kosovën. A po e luan sot rolin Vuçiqi si viktimë duke e dëmtuar Kosovën në arenën ndërkombëtare? Duke e pamundësuar integritetin e Kosovës drejt NATO-s, sepse siguria e këtij vendi do të jetë e plotë vetëm atëherë kur të jemi anëtar në Aleancën Veriatlantike.

Të nderuar kolegë deputetë,

Kështu, përtej kësaj seance, ne nuk mund të heshtim. Përveç që kemi të bëjmë me shkelje të betimit të deputetit, kemi të bëjmë me cenim të rendit kushtetues të Kosovës, kemi të bëjmë me

komunikim të fshehtë sekret me nëntokën serbe, me përfaqësuesin e BIA-s dhe të Vuçiqit. Kjo nuk mund të tejkalohet tutje.

Kuvendi nuk mund të vazhdojë punën në mënyrë normale sikur nuk ka ndodhur asgjë, kur situata është jonormale. Kjo është e njëjtë sikur mafia në Itali të vendosë cilat ligje duhet t'i votojë Kuvendi dhe cilët anëtarë të Gjykatës Kushtetuese duhet të zgjidhen atje. Po kjo nuk është situatë normale.

Unë ndjej keqardhje për deputetët e Vetëvendosjes, të cilët nuk kanë ardhur sot këtu. Populli ynë e ka një fjalë: “Më i keq se i keqi, është ai i cili e mbron të keqin”. Të gjithë ata përfaqësues të Lëvizjes Vetëvendosje dhe eksponentë politikë të Lëvizjes Vetëvendosje që sot e mbrojnë këtë akt komunikimi me Radojçiqin, me nëntokën serbe, me BIA-n e Vuçiqin, në mënyrë të fshehtë e të koordinuar...

KRYESUESI: Ia zgjat edhe dy minuta!

(Ndërprerje nga regjia)

BEKIM HAXHIU: Të gjithë ata të cilët e mbrojnë këtë komunikim me Radojçiqin, pra vendosen në mbrojtje të atyre, të cilët e dëmtojnë interesin e Kosovës.

Kur ne këtu në këtë seancë kemi kërkuar koordinim me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Bashkimin Evropian, Kurti tallej këtu se “a po doni me koordinim a pa koordinim”. E me kë paska qenë ky i koordinuar? Kur këtu tallej me opozitën, atje koordinohet me Radojçiqin. Prandaj, është tallur këtu në atë nivel. Kjo nuk mund të kalojë, se prapa krejt kësaj maskarade dhe tradhtie kombëtare qëndron Albin Kurti, i cili përveç takimit në Binçë, duhet të japë edhe llogari se si vetëm ai nga të gjithë të burgosurit shqiptarë politikë ishte i falur dhe jo i liruar. “Pomilovan” nga Koshtunica.

KRYESUESI: Fjala është për Rrezarta Krasniqin.

RREZARTA KRASNIQI: Faleminderit nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Skandali ‘Zdravo’ nuk mbaron me kaq, sepse pazaret me kriminelin Radojçiq janë edhe më të mëdha. Kur doli skandali i përgjimit të parë, nuk ishte diçka që nuk e kemi pritur, sepse jemi mësuar që ky kryeministër të glorifikojë kriminelët serbë ashtu siç ishte rasti me Oliver Ivanoviqin, i cili ishte i akuzuar për krime lufte në vitin 1999, si dhe vrasjet e rënda në vitin 2000. Po ashtu, ishte shpallur fajtor dhe ishte dënuar me nëntë vjet burg.

Përgjimet e fundit nxorën në pah koordinimin e fuqishëm të Albin Kurtit me Radojçiqin përmes veglave të tyre, Mimozen dhe Slavko Simiqin. Pra, Mimoza nuk është fajtorja e vetme, sepse vetëm urdhrat e shefit të saj i ka zbatuar, për të cilat favore për t'i lënë veteranët jashtë rritjes së pagave.

Të dashur qytetarë,

Pra, u bënë bashkë Albini e Radojçiqi, Mimoza e Slavko për t'i lënë jashtë rritjes së pensioneve veteranët dhe paramendojeni, për zgjedhjen e një gjyqtari të Gjykatës Kushtetuese.

Nuk është vetëm akt tradhtie, por është idiotësi e llojit të vet që agjenda e Kuvendit dhe organit më të lartë gjyqësor, pra Gjykata Kushtetuese të dirigjohet nga agjenda e terroristit Radojçiq. Është e turpshme dhe e neveritshme zhurma e krijuar për t'u hedhur hi syve të qytetarëve. Çka ndodh? Albin Kurti e Mimoza e Vetëvendosja tentojnë t'ua lënë fajin gazetarëve. Po tentojnë t'ua lënë fajin gazetarëve që po e bëjnë punën e tyre për të informuar qytetarët për veprimet kundër shoqërisë dhe kundër Republikës. E faji ka vetëm një adresë, Albin Kurti dhe Mimoza Kusari, të cilët kanë bërë pazare të ndyra me një terrorist serb, duke dëmtuar interesat e veteranëve të UÇK-së e duke cenuar pavarësinë e organit më të lartë kushtetues.

Koordinimi me kriminelin Radojçiq dhe biseda me të ka ndodhur pasi është futur në listën e zezë nga SHBA dhe pasi që ka pasur fletarrestim nga Policia e Kosovës. Është e turpshme, e tmerrshme dhe për qytetarët e Republikës së Kosovës që nga kryeministri Kurti kërkohet koordinim me një kriminel, i cili organizoi edhe sulmin në veri dhe vrau heroin tonë Afrim Bunjaku. Pastaj kanë fytyrë e shkojnë e vizitojnë familjen e tij dhe bëhen sikurse nuk ka ndodhur asgjë. Ndërsa vetëm pak muaj më parë kanë bërë pazare në kurriz të Republikës.

Ky njeri e ka dëshmuar ndër vite se është i gatshëm të shkelë mbi trupat e njerëzve të vdekur, vetëm për të arritur të qëndruar në pushtet, ky Kryeministër ka kaluar çdo limit, duke shkelur mbi varrin e heronjve sikur Afrim Bunjaku dhe mbi mundin e sakrificën e veteranëve, vetëm për të përmbushur kërkesat e mercenarit të Vuçiqit, Milan Radojçiq.

Republika e Kosovës kurrë s'ka qenë në pozitë më të keqe ndonjëherë. Ky Kryeministër kërkoi para aleatëve tanë të ekstradohet dhe të burgoset Radojçiqi dhe njëkohësisht bën pazare bashkë me të. Është totalisht joserioze karshi aleatëve, një Kryeministër që paradite e shan dhe pasdite bën marrëveshje me një superkriminel sikur është Milan Radojçiq. Prandaj, Albin Kurtit dhe grupit të tij kriminal më 9 shkurt do të marrin dënimin e merituar, sepse dëmet janë të mëdha dhe janë gjithashtu në favor të Serbisë.

Këto dëme që po shkaktohen nga pazaret e Albin Kurtit po e bëjnë një Kosovë të dobët. Një Kosovë të dobët e do vetëm Vuçiqi. Ne jemi të dobët, për arsye se jemi nën masa nga Bashkimi

Evropian, nuk ka zhvillim ekonomik dhe kjo është gjithçka që është në kuadër, që i konvenon vetëm Vuçiqit.

Të dashur qytetarë,

Çdo fjalë e tepërt është e tepërt për veprimet e fundit të Kryeministrit Kurtit dhe mashës së tij, Mimoza Kusarit. Do t'ju mallkojnë gjenerata të tëra për dëmin që i keni shkaktuar Republikës së Kosovës, turpi u mbuloftë për poshtërimin që ua keni bërë veteranëve dhe atyre që luftuan kundër ushtrisë së Milosheviqit dhe kriminelëve si Milan Radojçiqi.

KRYESUESI: Nga Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, znj. Bytyqi.

ALBANA BYTYQI: I nderuar nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Qytetarë të Kosovës,

Sot, këtu jemi mbledhur për të kërkuar përgjegjësi për një akt të paprecedent dhe të papranueshëm për shtetin dhe për shoqërinë tonë.

Kohëve të fundit kemi qenë dëshmitarë të një skandali të thellë, një akt që tronditi thellësisht themelet e besimit të qytetarëve në institucionet dhe minoi sigurinë kombëtare të vendit tonë.

Shefja e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, znj. Mimoza Kusari, është kapur duke biseduar me një kriminel serb, i cili në kohën e bisedës gjendej në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe i kërkuar nga drejtësia vendore.

Ky kriminel tashmë i dëshmuar edhe në sulmin terrorist në Banjskë, si udhëheqës i sulmit kundër shtetit të Kosovës, një akt i rëndë terrorist që pati për synim aneksimin e territorit të Republikës së Kosovës dhe që i kushtoi vendit me humbjen e rreshterit Afrim Bunjaku.

Vetëvendosje dhe Mimoza Kusari për vite me radhë ka ndërtuar një retorikë të ashpër e linçuese kundër kujt do që ka bashkëpunuar me Listën serbe apo me përfaqësuesit e komunitetit serb në Kosovë. Por, sot e njëjta parti dhe e njëjta zonjë, janë të zhytur në biseda të fshehta me kriminelët, një terrorist që kërcënon paqen dhe sigurinë e vendit tonë.

Kjo hipokrizi është e papranueshme dhe e patolerueshme që ata të flasin për llogaridhënie dhe drejtësi, të jenë të përfshirë në veprime të fshehta me individë që përfaqësojnë të keqen më të madhe për këtë vend.

Ajo që kanë zbuluar mediat e respektuara vendore është një thikë pas shpine për të gjithë ata që besuan në një qeverisje të drejtë, të sigurt dhe demokratike nga Lëvizja Vetëvendosje.

Le të jemi të qartë, kjo nuk është vetëm një çështje e etikës politike. Kjo është një çështje e tradhtisë ndaj shtetit. Është një goditje e drejtpërdrejtë ndaj sigurisë sonë kombëtare.

Si mund të pranojmë që njerëzit që flasin në emër të popullit të Kosovës, të bëjnë marrëveshje në errësirë me ata që janë të kërkuar për krime të rënda dhe për akte terroriste. Ne nuk mund të qëndrojmë të heshtur. Kjo kërkon veprim të menjëhershëm nga organet e drejtësisë. Hetimet duhet të fillojnë pa vonesë. Dhe, të gjithë ata që janë të përfshirë në këtë aferë të turpshme duhet të mbajnë përgjegjësi të plotë.

Andaj, qytetarët e Kosovës meritojnë një qeverisje të drejtë, të pastër dhe të përgjegjshme. Kjo është një pikë kthese. Ata që e kanë tradhtuar besimin e këtij populli, që kanë bashkëpunuar me ata që na kërcënojnë, duhet të përgjigjem.

Ne si përfaqësues të këtij populli nuk duhet të lejojmë që të vazhdojnë të manipulojnë dhe të shkelin mbi interesat kombëtare të Kosovës.

Të dashur qytetarë,

Kjo nuk është një lojë politike. Kjo është e ardhmja e Kosovës, dhe unë kërkoj që ne të qëndrojmë të bashkuar në kërkesën tonë për drejtësi dhe transparencë. Andaj, koha është për llogaridhënie dhe ajo ka ardhur.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete! Fjalën e ka Ganimete Musliu nga Partia Demokratike e Kosovës.

GANIMETE MUSLIU: Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

I nderuari nënkryetar i Kuvendit, zoti Enver Hoxhaj,

Këtu e kanë sjellë vendin edhe Kuvendin, Lëvizja Vetëvendosje dhe Albin Kurti. Në vend se të flasim për hallet e qytetarëve të Republikës së Kosovës, ne e kemi sjellë Radojçiqin në Kuvend dhe duhet të merremi me të. Është i rrezikshëm, sepse e kanë lënë që të ikë nga Kosova.

Do të filloj me disa çështje për të ardhur deri te çështja e Radojçiqit. Ky mandat qeverisës po përfundon ashtu siç ka nisur keq. Në vitin 2021 filloi me manipulimin e sistemit, ku personi i cili me vendim të gjykatës nuk u lejua të jetë pjesë e zgjedhjeve, u katapultua në krye të Qeverisë.

Që atëherë aq shumë është bombarduar populli me rrena sa që as sot gjysma nuk e dinë që Albin Kurti nuk ishte fare pjesë e garës zgjedhore. Para pothuajse 4 viteve dikujt i leverdisi që ky person të vinte në krye të Qeverisë dhe përse i leverdisi e tregojnë pastaj shumë ngjarje që pasuan.

Ky person u leverdisi atyre që e kishin kuptuar se disa procese shumë të dëmshme për Kosovën mund t'i shtynin përpara vetëm me një person si ky llaskuç politik dhe pa asnjë kriter njerëzor e kombëtar.

Ky mandat filloi me shkelje ligjore dhe rrena dhe po përfundon po ashtu me shkelje ligjore e me rrena, por fatkeqësisht edhe me tradhti. Bashkimi kombëtar, dialogu, rryma, çmimet, banimi i përballueshëm, zhvillimi ekonomik, sigurimet shëndetësore, reformat në arsim, në shëndetësi, në drejtësi, zvogëlimi i ministrive, xhipat e zinj, punësimet, rinia, diaspora, nepotizmi, klientelizmi, rezervat e shtetit, pagat, sindikatat, administrata, janë vetëm disa nga temat të cilat kjo Qeveri, jo që i ka lënë në status qou, por i ka degjeneruar në tërësi e në thelb.

Kjo Qeveri nuk ka bërë asgjë përveç filmave të dobët propagandistik. Po risjellim pak në kujtesën e qytetarit se pothuajse gjatë katër viteve të kësaj keqqeverisje, Vetëvendosje më shumë i bëri opozitë Partisë Demokratike sesa që u mor me qeverisjen dhe me realizimin e premtimeve që ua kishte bërë qytetarëve.

Po ashtu, krejt e thjeshtë, sepse edhe 100 vjet pas nëse qeverisë Lëvizja Vetëvendosje nuk ia del, jo të barazohet, por as të afrohet me sukseset e Partisë Demokratike. Dhe, ky fakt e lë pa gjumë Binin. Ky fakt është guri që ia rëndon qafen Binit dhe kompanisë së tij, dhe ky gur do të jetë stigma e tyre e përjetshme.

Lëvizja Vetëvendosje mburret se po arrin t'i mashtrojë qytetarët e vet, por qytetarët e Kosovës e kanë kuptuar se Lëvizja Vetëvendosje nuk di dhe nuk do të qeverisë me këtë vend. Lëvizja Vetëvendosje të vetmin qëllim politik që e ka, e ka karrigen e pushtetit siç e tha edhe Haki Abazi, dhe këtë po tenton ta mbrojë me çdo kusht dhe me çdo mjet.

Qytetarët e kanë kuptuar, e ka kuptuar edhe vet Albini, edhe Mimoza, edhe Dejana Mihali, që qytetarët e Kosovës nuk janë analfabetë funksionalë siç i quante ai dikur. Tani, kur dita u duket se zgjat vetëm 5 minuta, të gjendur para zgjedhjeve të reja parlamentare dhe pa asnjë sukses të vetëm, ka nxjerrë armën e tyre kryesore për të mbijetuar politikisht.

E kanë ashpërsuar gjuhën e denigrimit përballë partive të tjera opozitare, e me theks të veçantë, të Partisë Demokratike të Kosovës, dhe pa fije turpi dalin dhe krejt marrëzitë e veta mundohen t'i pozicionojnë tek taborët e oponentëve politikë.

Nuk ka për t'ju funksionuar më. Të gjithë e keni kuptuar se ky Kabinet qeveritar dhe ky grup parlamentar vjedhin, rrejnë, shkatërrojnë, izolojnë, pranojnë autonomi për serbët, bllokojnë, bojkotojnë, e çka mos tjetër. Dhe, nëse dikush i kritikon, dalin e bërtasin, luftë hibride.

Në realitet 90% e këtyre që do të duhej të ishin sot këtu, as që e kuptojnë se çka është lufta hibride. Por, e zgjedhin këtë term për efekte elektorale për t'u dukur të dijshtë apo për t'u

viktimizuar, por qytetarët e kanë kuptuar se $X=0$, dhe jo 5, siç u thoshte lideri i tyre. Dija juaj u pa. Dijen tuaj e vuajti ky popull mbi kurriz për më shumë se 4 vjet. 9 shkurti po afrohet dhe juve u ka kapur një ankth i madh.

Të ndalem pak te seanca e djeshme e Kuvendit. Dje në seancë të këtij Kuvendi, shefja e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, Mimoza Kusari-Lila në vend që të argumentonte veprimin e saj koordinues me kriminelë të kërkuar nga organet e drejtësisë së Republikës së Kosovës, zgjodhi të çirrej, duke bërë titur se na qenka viktimë e një lufte hibride, e një kompanie linçuese e çka jo tjetër.

Sipas Mimosës, ne mund të bëjmë gjithçka, dhe më vonë kur të thirremi në përgjegjësi, të viktimizohemi. Jo, kjo nuk funksionin kështu, Mimosë. Jo. Je deputete dhe mbaje përgjegjësinë për veprimet e tua edhe kur ato veprime i bën për shkak të oportunitetit tënd të tepruar politik për çfarë edhe njihesh në publik.

Mbaje përgjegjësinë edhe nëse ato veprime i bën për t'i bërë argat shefin tënd, Albin Kurtit apo dikujt tjetër. Je e rritur dhe veprimet e tua mbaj me përgjegjësi. Mimosë, e mbështetur pas murit, për fajin tënd kuptohet, thatë, audio-incizimet janë të montuara, por ne i kemi fotot e të tjerëve dhe paramendojeni nëse i nxjerrim ato.

E përmende Listën serbe, i demonizove ata që kanë bashkëpunuar me ta në Kuvendin e Kosovës, duke përçarur tërthorazi sinjalin që të gjithë të tjerët janë tradhtarë e kriminelë. Fjalitë e tua ishin të studiara dhe të mirë-mësura, propagandë hesapit, gjë edhe për të cilën njihesh.

Megjithatë, Mimosë, të bëj thirrje publike t'i nxjerrësh, jo vetëm fotot, por çfarëdo që keni, sepse nëse i mbani për vete, kjo do të thotë se po i mbani për shantazhe politike. Kjo sjellje dënohet me ligj. Dhe, jam shumë e indinjuar që prokuroria e vendit tim nuk ju detyron t'i nxirrni të gjitha gjërat në të cilat ju përpiqeni të shantazhoni skenën politike. Dhe, nëse vet video-incizimet mund të manipulohen siç pretendon ti, pse të mos mund të keni manipuluar edhe ju fotot që ti pretendon që i ke.

Apo, ju keni të drejtë gjithmonë dhe të tjerët jo. Apo, i mbani për të shantazhuar politikanët e tjerë dhe kështu për të manipuluar rezultatin e zgjedhjeve. Për çfarë nuk i nxirrni, sepse ky lloj mentaliteti që ju e keni bërë normë në politikë, jo vetëm që është i gërditshëm, por është edhe i rrezikshëm për vendin tonë.

Mimoza Kusari-Lila, ti e akuzon Partinë Demokratike që e ka pritur Listën serbe për të krijuar qeverinë. Në realitet Lista serbe është kategori kushtetuese dhe është pjesë e çdo qeverie njëjtë sikurse dhe partitë e tjera të minoriteteve. Lini propagandën. Lini rrenat. Lini patriotizmin falso.

Dhe, që ta kesh të qartë ti dhe kushdo, ti Mimosë nuk po akuzohesh se përse paske folur me Simiqin apo përse e keni në Qeveri edhe Listën serbe edhe minoritetet e tjera, por po akuzohesh që përmes Simiqit ke koordinuar vendimet me Radojçiqin e kërkuar nga organet e drejtësisë së vendit tënd.

Po akuzohesh, sepse e ke përfshirë çështjen e veteranëve të luftës dhe ke përdorur gjuhë denigruese për ta dhe për kolegët tuaj deputetë. Duhet të të vijë marre. Po akuzohesh, sepse po e sulmon median e lirë dhe po i akuzon për manipulime. Po akuzohesh thjesht, sepse për të qenë dikushi je në gjendje që të bësh gjithçka. Dhe, dikushi për interes të vetin bën gjithçka nuk është i denjë për poste të larta politike. Kaq e thjeshtë është.

Ti e di, prandaj e humbe kontrollin dje. Dhe, me plot të drejtë, sot, ne dhe qytetarët e Kosovës shtrojmë një pyetje së cilës ju herët a vonë duhet t'i përgjigjeni; çfarë pazaresh keni bërë me Radojçiqin? Çfarë pazaresh keni bërë që Radojçiqi u lejua të largohej nga Kosova pas Banjkës, për çfarë jeni dakorduar me të? Pse e keni bërë, apo me urdhër të kujt i keni bërë këto marrëveshje?

Për të gjitha këto duhet të përgjigjesh para popullit, por edhe para drejtësisë. Viktimizimi nuk të ndihmon. Viktimizimi nuk të nxjerrë nga llumi i Albin Kurtit në të cilin je futur për shkak të oportunitetit tënd politik, sepse je e rritur dhe askush nuk mund të detyrojë të bësh diçka kundër dëshirës.

Duhet të përgjigjeni, sepse Kosova nuk është pronë private juaja që të bëni çfarë të doni. Keni vetëm mandat qeverisës dhe ky mandat po ju skadon. Ju po mbeteni pa marrë përgjegjësi të cilat ua keni premtuar qytetarëve dhe do të dilni të turpëruar deri në palcë.

Tashmë është raportuar se Radojçiqi vilën e ka ndërtuar para hundëve të Qeverisë së Albin Kurtit. Të gjitha materialet që janë gjetur në këtë vilë dorëzoni në prokurori në mënyrë që ata janë të përfshirë në krim të dalin para drejtësisë...

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ia zgjatni kohën dy minuta që ta përmbyllë fjalën.

GANIMETE MUSLIU: Shantazhet e tua politike se keni materiale që mund t'i përdorni duhet të jenë po ashtu subjekt i hetuesisë. E shfrytëzoj rastin që nga ky Kuvend t'i bëj thirrje prokurorisë që t'i nis hetimet për të parë se kush ka qenë i përfshirë në krim. Kush po shantazhon. Kush po monton dhe kush po rren e po e manipulon këtë popull.

KRYESUESI: Fjalën e ka Besian Mustafa.

BESIAN MUSTAFA: Faleminderit, kryesues!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës, e mbi të gjitha prokurorë të Shtetit të Republikës së Kosovës, sot për juve nuk ka detyrë më urgjente, nuk ka detyrë më të rëndësishme se të hetoni çka ka ndodhur mes shefes së deputetëve të Lëvizjes Vetëvendosje, e cila nën mbikëqyrjen, nën urdhrin e shefit të saj, pra, Albin Kurtit, ka pasur një ose më shumë biseda telefonike për t'u koordinuar me terroristin, me njeriun e përndjekur, të arratisur nga Kosova, me njeriun në listën e zezë të Amerikës, Milan Radojçiq.

Prokurorët e Shtetit të Republikës së Kosovës duhet që sa më parë, filluar nga ky moment, nga ky sekondë të nisin hetimet për t'u përgjigjur në një mori pyetjesh; pse duhet që shefja e deputetëve të VV-së nën urdhrat e shefit të saj, Albin Kurti, të diskutojë e të negociojë me një terrorist në arratisje, Milan Radojçiq, për përfshirjen apo largimin e veteranëve të UÇK-së nga Ligji për pagën minimale?

Pse, për çfarë arsye, me çfarë zori duhet ajo të diskutojë e negociojë me një terrorist të arratisur për emërimin e gjyqtarëve në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës? Atë Gjykatë Kushtetuese, ku secili ministër i kësaj Qeverie, i këtij pushteti, e sulmon për secilin vendim që merr ajo Gjykatë Kushtetuese, duke ekspozuar shkeljet kushtetuese të kësaj Qeverie. Këta e sulmojnë e në anën tjetër, shefja e deputetëve të Vetëvendosjes, nën urdhrin e Albin Kurtit, negocion me terroristin e arratisur Milan Radojçiq për të emëruar gjykatës në po atë Gjykatë Kushtetuese? Çfarë arsyeje, çfarë zori kanë këta njerëz?

Prokuroria duhet të fillojë këto hetimet, të përgjigjet në këto pyetje nga ky moment. Më e rëndësishme se kjo, çka ka kërkuar terroristi i arratisur Milan Radojçiq në këmbim për këto negociata, për këto të mira që i ka bërë shefes së deputetëve të VV-së nën urdhrin e Albin Kurtit? Sepse, ai në ato përgjime shihet qartazi, dëgjohet qartazi që kërkon diçka në këmbim.

Në anën tjetër, votimi i tyre në Kuvend është më se i qartë, por ajo që nuk dihet, ajo që duhet të zbulojnë hetuesit, prokurorët e Republikës së Kosovës, është se çka i dhanë Milan Radojçiqit, terroristit të arratisur, njeriut në listën e zezë të Amerikës, çka i dhanë në këmbim.

Kjo është e rëndësishme për interesin kombëtar të Kosovës, për sigurinë nacionale të Republikës së Kosovës. Ky hetim duhet të fillojë që sot. Prokurorët e Republikës së Kosovës nuk kanë asnjë detyrë, asnjë punë më të rëndësishme se interesi nacional, se siguria nacionale e Kosovës, e cila shihet, dëgjohet qartazi se është rrënuar në këto telefonata mes shefes së deputetëve të Vetëvendosjes nën urdhrin e Albin Kurtit.

E në anën tjetër, është e paimagjinueshme, është e tmerrshme që kjo Qeveri dhe të gjithë ne kërkojmë nga aleatët tanë që të na përkrahin e të na ndihmojnë në avancimin e interesave të

Kosovës, në avancimin dhe mbrojtjen e sovranitetit të Republikës së Kosovës, e në anën tjetër, udhëheqësit më të lartë të shtetit të Kosovës në këtë pushtet, nga kjo parti në pushtet, negociojnë, organizohen, koordinohen me terroristin e arratisur, me njeriun në listën e zezë të SHBA-ve, Milan Radojçiq, për vendimmarrjen e organeve, e institucioneve të shtetit të Republikës së Kosovës.

Si mund t'u kërkojmë aleatëve tanë të na përkrahin në pavarësi, në avancimin e interesave tona, në mbrojtjen e sovranitetit tonë, kur për punë të përditshme, për Gjykatën Kushtetuese, për veteranët e UÇK-së, kjo Qeveri koordinohet me një terrorist të arratisur, me njeriun në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Prandaj, them edhe njëherë, hetimet nga ana e Prokurorisë së Shtetit janë të domosdoshme, janë urgjente që të përgjigjen në këto pyetje të interesit nacional, të sigurisë kombëtare të Republikës së Kosovës. Prokurorët e Kosovës nga dje nuk kanë detyrë më të rëndësishme. Nuk kanë obligim më patriotit se sa të gjejnë përgjigje në këto pyetje. Faleminderit!

KRYESUESI: Fjalën e ka deputeti Shemsedin Dreshaj.

SHEMSEDIN DRESHAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,

Të nderuar kuvendarë,

Qytetarë të vendit,

Vërtet unë e kam pasur një bisedë pak më ndryshe ta bëj, por sot, në mungesë të mazhorancës, do ta formuloj pak më ndryshe me pyetjen e parë.

A thua ku janë sot, dha a ju kujtohet çfarë janë bërë dje. Do t'ia kujtoj mazhorancës dhe pjesës që jeni këtu, që vendasin e zonjës Kusari, zotin Radojçiq nga Gjakova e ka hequr Ramush Haradinaj me UÇK-në, atëherë kur ka qenë koha në vitin 1999.

E tash, pas 25 vjetësh, siç duket, këta i ka marrë malli e po e lypin përsëri të kthehet në vend.

Të nderuar qytetarë,

Të nderuar deputetë,

Jua kujtoj që mazhoranca bashkë me neve ka dhënë një betim për ruajtjen territoriale dhe legjislative të Kosovës. Veprimet e djeshme të tyre kanë qenë bash kundër asaj në çka janë betuar.

Guximi i shefes së Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes, qartë tregon se në prapavijë ka shumëçka që do të bëhet publike më vonë, qoftë në përmbajtje në atë çfarë krejt ka ndodhur, e po ashtu edhe në atë se kush qëndron prapa zonjës Kusari.

Në variantin më të mirë, lirimin nga përgjegjësia për gabimet e bëra është normale, por një skandal i tillë nuk arsyetohet vetëm me shkarkim. Këtu ka dyshime për tradhti kombëtare dhe kërkohet përgjegjësi në secilin nivel të vendit.

Kjo legjislaturë karakterizohet vërtet më shumë dështime. Unë do t'i përmend disa nga to. Karakterizohet me: keqmenaxhim, me cenimin e tërësisë territoriale dhe legjislative të vendit.

Shembull tipik i kemi pasaportat ilegale të legalizuara nga ana e Bashkimit Evropian për qytetarët e Kosovës, dhe çfarë bëri qeveria në këtë drejtim? Asgjë. Cenim i sigurisë së vendit, e kemi rastin tipik të Banjskës. Dy vjet u deshën që të bëhet një raport në këtë drejtim, në atë mënyrë të identifikohen kush ishin pas saj. Keqmenaxhimi nuk ndalet me kaq, vazhdon me prishjen e raporteve ndërkombëtare dhe këto prishje e sollën dinarin nga një çështje puro vendore, në Këshillin e Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.

A ka ma zi, edhe rezervat e shtetit u keqpërdorën, kemi rastin në gjykatë tash. Kjo qeveri karakterizohet me veprime postfestum, pa përfitime të vendit, veprimet duke i bërë në minutën e fundit, pra asnjë qëndrim, të gjitha tërheqje, atëherë kur vendi nuk përfiton asnjë gjë. Për aspektin ndërkombëtar të mos flasim, veç mund ta përmendim largimin nga Defender 23, çka doni më zi. Menaxhimi i vendit me lëmosha dhe me shantazhe. Ju them diçka, këto pika që i numërova mund ta merrni një libër që e ka emrin “Kosovo”, e ka shkruar Dobrica Qosiq, fund e krye këto pika janë të elaboruara aty dhe i shihni që hapat e ndërmarrë fatkeqësisht shkojnë në favor të kësaj strategjie që është e shkruar dhe e hartuar aty.

Pyes çka duhet t'i ndodhë këtij vendi që dikur të bartë përgjegjësi për veprime tilla, a thua mos duhet të shkojmë dhe të kërkojmë leje dhe negociata me Radojçiqin për t'ua blerë edhe pasulin ushtarëve që sot i keni të rebeluar. Nuk dua të bëj kërcënime këtu, por vetëm dua t'ju bëj me dije që ky vend është krijuar me mund e me gjak. Ata që e kanë krijuar dhe e kanë mbrojtur deri më sot, prapë do ta mbrojnë. Kosova është amanet, amanet i të gjithëve. Ata që dalin në rrugë, binduni që do të pësojnë keq. Ju kujtoj që një krua që ka rrjedhur një herë, prapë do të rrjedhë, e Kosova do të ekzistojë me mazhorancë ose me opozitë. Ju faleminderit!

KRYESUESI: Tani fjalën e ka zonja Deliu-Kodra.

BLERTA DELIU-KODRA: Faleminderit, i nderuar nënkryetar i Kuvendit të Kosovës!

Të nderuar kolegë deputetë nga opozita,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Është për keqardhje kjo pamje, në fakt, kjo zbrazëti e kësaj shumice, e cila sot nuk është këtu, e para flet për përgjegjësinë që ata e kanë para qytetarëve të Kosovës, sepse kolegët deputetë në vështrimin tim dhe si një deputete me disa mandate unë mendoj që edhe në radhët e tyre ka deputetë, të cilët e kanë një pikë integriteti. Dhe, unë ndihem keq, jam ndier edhe dje, keq për

strukjen, të cilën e kam parë, për pafuqinë e një deputeti të zgjedhur, i cili nuk e ka kurajën që edhe atëherë kur ndihet në siklet e ndihet keq, ta thotë një fjalë të vetme, dhe këtë e kam ndier edhe dje, dhe unë jam e bindur që prej tyre janë shumë, të cilët nuk pajtohen me koordinimin e shesës së Grupit Parlamentar me të kërkuarin e SHBA-së, të prokurorisë së shtetit, i cili është në listën e zezë, kryekrimineli Milan Radojçiq.

Unë nuk e di se çfarë do t'u thonë nesër qytetarëve këta që do të dalin në zgjedhje, sepse unë nuk e marr dot me mend që 25 vjet pas luftës fatin e veteranit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, fatin e invalidit, fatin e familjeve të dëshmorëve do ta marrë në dorë një kryekriminel, i cili do të vendosë që ata t'i përjashtojë nga paga minimale. Pra, qysh mundet, më thoni ju mua, sot dikush t'i përkulet sakrificës së togerit, të rënë në detyrë, Afrim Bunjaku, dhe të përkulet para tij dhe të bëjë pazar në të njëjtën kohë me kryekriminelin Milan Radojçiq. Unë jam e bindur që këto dy gjëra nuk shkojnë bashkë, nuk shkojnë assesi bashkë. Dhe ky është cenim i sigurisë së shtetit të Kosovës, kjo është skandaloze, sepse brenda institucioneve të Kosovës sot përcaktojnë agjenda, zgjedhin anëtarë të Gjykatës Kushtetuese, njerëz të cilët do të duhej të ishin në grila për krimin monstroz që e kanë bërë në Kosovë.

Pra, për mua është vetëm një pyetje e çuditshme, pse janë bërë bashkë Lëvizja Vetëvendosje me Listën serbe? Çka u kanë bërë atyre ushtarët e UÇK-së? Çka u ka bërë atyre një invalid i luftës së UÇK-së? Çka u kanë bërë atyre familjet e dëshmorëve? Për çfarë arsye ata kanë zgjedhur që bashkë me Radojçiqin të njëjtit të mos i përfshijnë në pagën minimale. Është shokuese, kolegë deputetë, me çfarë lehtësie bisedohet me Radojçiqin për njërën prej ligjeve më të ndjeshme, për kategoritë tona më të ndjeshme me lehtësinë më të madhe zonja Mimoza Kusari-Lila. E bindur jam që e koordinuar me kryeministrin Kurti flet me lehtësinë më të madhe që ata t'i përjashtojë nga paga minimale.

Pra, kjo është hipokrizi dhe zonja Kusari-Lila duhet të vijë këtu dhe të tregojë publikisht pse ka pasur nevojë të komunikojë me Radojçiqin, kush e ka udhëzuar, sepse unë jam e bindur që Mimoza Kusari nuk ka komunikuar kokë me vete, ajo ka komunikuar në emër të qeverisë, në emër të pushtetit, në emër të Albin Kurtit dhe duhet të dijë pse ka komunikuar me një njeri që është në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe për këtë unë ftoj prokurorinë bashkë me kolegët e mi që sa më parë të merret me rastin, sepse a e dini se çfarë na kanë thënë ju që jeni sot këtu, e dini të gjithë, na kanë thënë se propaganda e po këtij pushteti na ka thënë që ne nuk komunikojmë asnjëherë me zyrtarët që janë në listë të zezë edhe me Listën serbe.

Ndërkohë, që janë marrë vesh me një kryekriminel, i kanë lënë veteranët që po protestojnë jashtë pagës minimale e me lehtësinë më të madhe shesha e grupit parlamentar del në konferencë, pa fijen e turpit, kolegë deputetë, e akuzon Partinë Demokratike të Kosovës që i paskan shtirë në sallë Listën serbe.

A po e kuptoni, kolegë? Pra, me urdhër të Milan Radojçiqit vendosin bashkë për veteranët, kryhet seanca, votohet ligji, e çka ndodh? Del shefja e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes në konferencë e thotë që PDK-ja paska gisht në bashkëpunim me Listën serbe. Kjo është skandaloze, e turpshme, kjo tejkalon çdo kufi etik, e tejkalon çdo kufi moral, çdo kufi njerëzor, kjo është poshtërsi, kolegë e qytetarë të Kosovës.

Këta kanë bërë pazare me Radojçiqin e kanë provuar t'ia lënë fajin Partisë Demokratike të Kosovës, kjo është gjëja më e poshtër që mua më ka rënë të dëgjoj ndonjëherë. Ta komprometosh Partinë Demokratike të Kosovës ose, thënë më shkurt, kjo i bie “me e gjuajt gurin e me fshehë dorën”. E, këtë ata njerëz, të cilët kanë dinjitet e integritet, nuk e bëjnë dhe jo veç koordinimi me Radojçiqin që është shumë problematik për mua, për mua është problematike shumë edhe lehtësia me të cilën, kolegë deputetë, ky pushtet rren, më falni për gjuhën time, ky pushtet rren, kryeministri lehtësisht rren.

Unë i kam dëgjuar bisedat, na tha Kurti, por ato janë luftë hibride, luftë hibride kur zonja Kusari Lila zotohej se do të flasë me kryeministrin për t'i realizuar kërkesat e Radojçiqit, ose që po mundohem ta parafrazoj. Radojçiqi i thotë Kusarit “nuk shoh asnjë pengesë t'ju ndihmoj, por i kemi edhe ne disa kërkesa, të cilat t'i duhesh t'i shikosh me shefin tënd”. Mimoza Kusari nuk i thotë për asnjë moment të vetëm që nuk mundet të flas me Kurtin, se ai nuk po hynte në pazare të tilla, tash pyetja ime është: cilat paskan qenë kërkesat e Radojçiqin për Kurtin, të cilat nuk janë plotësuar ose janë plotësuar? Cilat janë ato kërkesa? E, tash qysh t'u besua ne këtyre njerëzve? Na kanë rrejtur sa e sa herë, kur doli afera e Martinit, Qeveria na tha se i beson Martinit e s'u beson fakteve. E, tash Kurti po na thotë që i beson Mimozës, e jo asaj që e paska dëgjuar i madh e i vogël.

Në korrik të vitit 2023, kur dolën audio-incizimet e para, na thanë që ajo paska fol në gjuhën shqipe me Radojçiqin, po del që ka rrejtur. Shefja e Lëvizjes Vetëvendosje tha se Radojçiqi iu ka ankuar për disa pakënaqësi për gjendjen në terren, në pjesën Veriore, për shkak të disa vendimeve të cilat i ka marrë nga Kurti. Po del që ka rrejtur. Pas seancës parlamentare kanë thënë që s'kemi pasur koordinim me Listën serbe për pagën minimale brenda Kuvendit, deputetët që janë betuar, kanë rrejtur. Kolegë deputetë, më lejoni t'ju them, e keni dëgjuar të gjithë deklaratën e Albin Kurtit në Këshillin Drejtues të Lëvizjes Vetëvendosje.

E tha një deklaratë shumë interesante, tha që Shtetet e Bashkuara të Amerikës është mirë t'i fusin në sanksione dhe njerëzit, të cilët kanë bashkëpunuar e kanë komunikuar me persona, të cilët janë në listë të zezë në Ballkan. Personat që janë në listën e zezë në Ballkan, ne e dimë për kë është fjala, për Radojçiqin. Person që ka bashkëpunuar me të është zonja Mimoza Kusari-Lila, a po i bie tash që zoti Kurti po u thotë Shteteve të Bashkuara të Amerikës të merren me të, ku në fund të fundit, prapë po e them, Mimoza Kusari-Lila ka kryer detyrën e ngarkuar nga zoti Kurti.

Dhe, për këtë duhet të japë përgjegjësi, sepse është e pamoralshme, është jashtë çdo etike dhe është jashtë komplet institucioneve të Republikës së Kosovës që në njërin anë të thirremi e të ftojme institucionet e drejtësisë që të ketë aktakuzë për Radojçiqin, e në anën tjetër, fshehtas, mbrapa perdeve atje diku, të koordinohemi e pastaj ta drejtojmë gishtin te dikush tjetër. Kjo është mungesë e moralit politik, unë kam pritur një fije dinjiteti te zonja Mimoza Kusari-Lila, e di që ka bredhur nëpër të gjitha partitë, por në fund të fundit, kam pritur që si shefe e grupit parlamentar do ta ketë një fije integriteti të saj personal që të dalë e të thotë sot që është e manipuluar, e nxitur dhe është e shtyrë nga kryeministri Kurti që të koordinojë politikën në dëm të Republikës së Kosovës.

KRYESUESI: Fjala është për Driton Selmanajn nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

DRITON SELMANAJ: I nderuar nënkryetar i Kuvendit,
Shumë të nderuar kolegë deputetë nga opozita,
Dhe, ju deputetë të mazhorancës që jam i sigurt që po na përcillni nga shtëpitë tuaja ose nga diku kudo që mundeni, sepse, t'ju them të drejtën, unë ju mirëkuptoj pse sot nuk jeni këtu, sepse jeni në gjendje të rëndë.

Të përkrahet Mimoza, i bie që po e përkrahni një veprim shumë të papranueshëm, antikombëtar, por të mos e pranoni ose të mos e lavdëroni Mimosën, ose ta kundërshtoni Mimosën, del një problem tjetër. Cili është ai? E hidhëroni Mimosën. Dhe kur të hidhërohet Mimoza, atëherë e thotë të vërtetën ajo, e kur ta thotë të vërtetën, i bie që s'ka folur në emër të vet ajo. Kështu që unë jam i sigurt, a e sheh edhe Albin Kurti, edhe Dejana Mihali edhe krejt Lëvizja Vetëvendosje do të kujdesen shumë të mos e zemërojnë Mimosën, vetëm nga frika që ajo më pas e thotë të vërtetën. Mimosën duhet mbrojtur këta, sepse e vërteta do të dhembë shumë më shumë se sa kjo që ka dalë.

Mimoza Kusari-Lila dhe kryekrimineli në atë anën tjetër që kanë biseduar nuk kanë folur kurrë asnjëherë në emër të tyre, absolutisht kurrë, asnjëherë në emër të tyre. Njëri ka folur si i deleguari i Vuçiqit, tjetra ka folur si e deleguar e Albin Kurtit. Dhe problemi kryesor këtu, të nderuar kolegë deputetë, është a kanë folur më tutje edhe për tema të tjera, apo vetëm për këto që ne i kemi dëgjuar deri sot. Unë druaj që kanë vazhduar këto bisedime edhe më tutje, sepse nëse nisemi nga fakti që SHBA-ja, aleati ynë kryesor, del na thotë që kjo qeveri merr vendime të pakoordinuara, domethënë ne nuk po koordinohemi me aleatët tonë, por dalin do përgjime që ne po koordinohemi me dikë tjetër, me armikun tonë.

Dhe, aleati ynë e vendos në listë të zezë një person dhe jo vetëm një person, por janë disa persona të Veriut dhe disa firma të Veriut, për krim trans nacional, thotë dhe që pengojnë edhe zhvillimin e vendeve të Ballkanit, kurse ne ose thënë Lëvizja Vetëvendosje, partia në pushtet, i koordinon gjërat me ta. Atëherë është problem serioz, çështje jo vetëm e sigurisë nacionale, është

çështje e rrugës që ka zgjedhur kjo qeveri të ecë tutje, mos për gjithçka ka koordinim me ta dhe jo me aleatët tonë, sepse aleatët tonë po dalin po thotë “me neve s’janë duke u koordinuar”.

Mos edhe 473-ditëshi që sot jemi nën sanksione, është dita e 473 sot, mos qenka e koordinuar me Beogradin. Dhe unë këto dilema i kam sot, sepse kur e shoh që ikin nga e vërteta Lëvizja Vetëvendosje, ose kur shoh që provojnë të sulmojnë për t’u mbrojtur, sepse ndihen në faj, atëherë dalin probleme serioze këtu. Unë t’ju them të drejtën, po dua ta shfrytëzoj rastin prej këtij podiumi t’i falënderoj dy gazetarë shumë të respektuar të Kosovës që i kanë nxjerrë këto përgjime. Ne si opozitë kemi dështuar në këtë segment, mund t’i thurim lavde vetes, por kemi dështuar. Mos harroni, me bombat e Zajevit është rrëzuar Qeveria në Maqedoni, si rezultat i punës së opozitës. Ne s’kemi arritur këtë ta bëjmë, por po dua dy gazetarët e nderuar, Berat Buzhala dhe Vehbi Kajtazi, të na furnizojnë neve dhe ta dekonspirojnë një logjikë politike shumë perfide që s’njeh historia e Kosovës, s’ka ndoshta edhe historia e shqiptarëve kaq mashtrues, kaq perfid dhe kaq mjeshtër të mashtrimeve dhe këtu po them i falënderoj vërtet seriozisht.

Unë dikur kur Lëvizja Vetëvendosje e zgjodhi Mimoza Kusarin shefe të grupit parlamentar, nuk arrija me kuptua si ka mundësi një parti politike që 51% të votave i fiton dhe për ta udhëhequr grupin parlamentar e zgjedh një person të një partie tjetër që kjo nuk u dëshmuar fare lojale ndaj asaj partie ose një person e cila ka defiluar në shumë parti të tjera politike. Po tash, po e kuptoj, këta e kanë gjetur dikë tjetër për t’i bërë këto gjëra dhe në fund ta martirizojnë politikisht atë.

A e dëgjuat Albin Kurtin në njërin nga intervistat tha nuk është e partisë time ajo, tha, e para tha kjo është luftë hibride, por dikur nuk e mohoi, tha ndoshta mund të ketë ndonjë bisedë që është e konstruktuar e kështu e kështu, tha por tek e fundit, tha ajo s’është e partisë time, se përndryshe tha kishte dhënë llogari në komisionet tona të brendshme. Shefi, domethënë veç filloi distancimi i parë. Por, nuk guxon, unë jam i sigurt që nuk guxon sot ta largojë prej shefes së grupit parlamentar veç nga frika e zemërimit të saj, e zemërimi e saj mund të nxjerrë të vërtetën që është problem serioz, më pas me gjasë do të dalin edhe gjëra të tjera.

Dhe, unë në këtë kontekst po dua t’i shoh dy përgjegjësi serioze të këtij procesi. E para është përgjegjësia penale, unë jam i bindur që në dy raste Mimoza Kusari, si shefe e Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, ka konsumuar në dy raste vepër penale. E para, është kur ti bisedon në funksion, si person publik, bisedon me një person që gjashtë muaj më përpara aleati yt, SHBA-ja e ka vendosur në listën e zezë, pra po ju them me datë, më 8 dhjetor 2021 SHBA-ja e vendosi në listë të zezë këtë farë personi, se s’po dua t’ia përmend emrin, se sot shumë u përmend. Gjashtë muaj më vonë, më 22 qershor, tash na del ky diskutim. Ndërkohë që kishte edhe një fletë arrest ose thënë ndjekje, ose thirrje nga organet tona të drejtësisë. Pra, kur një person publik bashkëpunon me një person, i cili është në ndjekje nga organet ndjekëse, është konsumim i veprës penale aty, ti ke bërë vepër penale vetëm që ke bashkëpunuar me të, e para.

E dyta, deklarinimet e zonjës Kusari-Lila dje, njëra nga to ishte, tha, “do të befasoheni ju kur t’ju dalin fotografitë dhe pamjet e njerëzve që kanë shkuar ta prenë shiritin kur ai personi atje, kryekrimineli ka hyrë në shtëpi të re dhe kanë dërguar dhurata njerëzit”. A shiko tash, domethënë kjo ka informata që një person që është vetë i 44-ti në aktakuzë tashmë prej shtetit të Kosovës, kjo ka informata që personat publikë të Kosovës kanë shkuar të prenë shiritin kur ai ka hyrë në shtëpi të re, e në shtëpi të re besoj ka hyrë vitin e kaluar, në bazë sa e pamë ne, atëherë dhe ti nuk po shkon në polici e prokurori t’i denoncosh këto, kjo është konsumim tjetër i veprës penale.

Dhe, tash unë po befasohem deri tash, deri në këto momente, qysh prokuroria speciale s’e ka thirrur urgjent. Urgjent duhet thirrur, kush janë këta njerëz që kanë shkuar, kanë prerë shirit në shtëpi të tij, kush janë këta njerëz që kanë dërguar dhurata për fëmijët, nëse pretendimet janë të sakta, nëse jo, atëherë duhet të përgjigjet penalisht për gënjeshtër, mashtrime, për fyerje dhe për gjithçka tjetër.

U tha disa herë për çështjen e temës për veteranët, në fakt, ne tash po e marrim vetëm këtë rast, por unë dyshoj që ka biseda shumë të thella. Tash, çështja e veteranëve, unë duke e dëgjuar edhe Hekuran Muratin, i cili pati thënë, nëse e mbani mend, pati thënë më lirë na kishin kushtuar mercenarët se sa ushtarët e UÇK-së, veteranët e UÇK-së. Madje pati thënë: “As faleminderit s’u kishim thënë atyre, i kishim paguar, na kishin çliruar dhe ishte kryer kjo punë”.

Albin Kurti, në tjetrën anë, tërë kohën edhe fyen një pjesë të madhe të luftës sonë çlirimtare, por edhe listën e veteranëve. Por, nga ana tjetër, s’ndërmerr asnjë veprim për t’i pastruar ato lista. Ok, kemi mendime që ka probleme në ato lista. Po cili është veprimi i kësaj Qeverie ose i Kryeministrit Kurti për t’i pastruar ato lista. Asnjë. Kjo i bie, mos kanë në formësimin e tyre të brendshëm anti-UÇK, antihistori të lavdishme të këtij vendi? Sepse, nëse e ke ministrin e Financave që thotë “më mirë me mercenarë të ishte çliruar Kosova” dhe nëse e ke Albin Kurtin, i cili kritikon, po nuk ndërmerr asnjë veprim për veteranët dhe në ndërkohë merr mundin të negociojë me kryekriminel për çështjen e veteranëve, këtu del problemi serioz më pas.

Cila është logjika prapa krejt kësaj Qeverie?

Të nderuar kolegë deputetë,

Unë e di që edhe u përsërita, por është problem të mos përsëritesh, sepse çështja është gati e njëjtë, por unë po them që ky rast është vetëm shpërfaqje e një logjike ose e një standardi shumë të mbrapshtë që është vendosur në Kosovë, që mashtrimi, gënjeshtër të jenë standarde të politikëbërjes, që mund të bashkëpunosh edhe me dreqin, edhe me armikun e vendit, po nuk duhet të bashkëpunosh me partitë shqiptare. Nuk duhet të bashkëpunosh me ata që dje kanë derdhur gjak për këtë vend, ose ata që kanë bërë shumë për lirinë dhe kanë hise shumë të madhe për lirinë, për pavarësinë dhe për konsolidimin e shtetit të Kosovës.

Prandaj, po them, kur e shoh krejt këtë qasje dhe krejt këtë përkushtim të Lëvizjes Vetëvendosje dhe këtë abstenim publik, them në Kosovë, aktualisht, për fatin e keq e kemi një lëvizje politike antishtet, një lëvizje politike anti-UÇK dhe një lëvizje politike e cila është kundër historisë së lavdishme të popullit të Kosovës. Faleminderit!

KRYESUESI: Kryetari i Grupit Parlamentar të Aleancës për Ardhmërinë e Kosovës, z. Tahiri.

BESNIK TAHIRI: I nderuar kryesues, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar deputetë të pranishëm,

Qytetarë të Republikës së Kosovës,

Opinionimi publik dhe të gjithë ata qytetarë, të cilët e ndjejnë dhimbjen për vendin dhe e kanë një brengë, është tronditur me publikimin e parë të gazetarit Berat Buzhala dhe publikimin e dytë të gazetarit Vehbi Kajtazi, të cilët i dhanë një kontribut goxha të madh trajtimin transparent një teme, e cila rrezikon të kthehet në një çështje, e cila ka elemente prej mashtrimit politik, manipulimit institucional, e deri te pazaret më të ulëta për ligje, për institucione të pavarura, si Gjykata Kushtetuese dhe çështje të tjera që ne nuk i dimë.

Ajo që unë mendoj është e vlefshme t'i thuhet qytetarit të Kosovës dhe t'i ripërsëritet është se kërkesa jonë, e tri grupeve parlamentare për të pasur një debat rreth kësaj seance, nuk lidhet shumë me atë që ju po e thoni në Lëvizjen Vetëvendosje se këtu jemi duke bërë politikë para zgjedhjeve. Po lidhet drejtpërdrejt me një brengë të thellë tonën, ku është lënduar drejtpërdrejt institucioni i Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe vendimmarrja demokratike në vend. Ta themi më troç, përmes atij komunikimi është shpërfaqur një goditje e madhe shtetit të Kosovës.

E tha më herët Bekë Berisha, po edhe disa kolegë të tjerë deputetë, po të ishte interesi puro elektoral, sot do të vazhdohej të diskutohej për gjendjen e rëndë sociale, për varfërinë, për gjendjen e rëndë ekonomike, shkatërrimin e sektorit privat, për pagat në sektorin publik dhe privat, për temën që e ngriti kolegu deputet, për mungesën e ushqimit për ushtrinë, për pushtimin ekonomik të mallrave serbe, të cilat edhe sot e kësaj dite nuk dihet cilat janë, edhe sot e kësaj dite nuk dihet se cili është vendimi i Qeverisë dhe cila është lista e artikujve që kanë hyrë përpara dhe janë duke hyrë e që mund të jenë potencialisht rrezik si në industrinë e ushqimit, mirëpo edhe në industrinë e tjera, dhe nuk po diskutojmë për sanksionimin, dobësimin dhe mënjanimin e Kosovës nga forume të rëndësishme ndërkombëtare, edhe nuk po diskutojmë se si ky kryeministër dhe kjo Qeveri po merr vendime, të cilat hap pas hapi po kthehen në probleme të mëdha dhe secili vendim, realisht për secilin vendim të kësaj Qeverie po paguajmë kamatë, po paguajmë çmim si Kosovë dhe qytetarët e Kosovës.

Pra, dua ta sqaroj. Po të ishim këtu për të bërë politikë elektorale të fokusuar në sektor, do të diskutonim këto tema. Mirëpo, për ne, kjo është një temë e cila meriton një përgjigje dhe transparencë.

Çka tjetër kërkuar në këtë seancë? Kërkuar ballafaqim. Ballafaqim me të vërtetën! Në qoftë se ekzistojnë argumente të tjera, të cilat do të duhej të mbroheshin nga pesëdhjetëpërqindëshi, të cilët morën një besim, atëherë do t'i dëgjoni këtu në foltore.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Po ju drejtohem juve. Kjo ikje është ikje me marre, se kurrë askush s'ka mundur ta mbrojë gënjeshtren dhe kurrë askush s'ka mundur ta mbrojë mashtrimin kur gjërat janë bardhezi. Janë tri elemente të cilat u shpërfaqën dhe nuk po dua të përsëritem, po dua pak t'i trajtoj prej këndvështrimin se si u munduan që ta manipulojnë opinionin publik rreth kësaj teme.

Kryeministri i Kosovës foli për një koncept që quhet “luftë hibride”. Tash, për ju qytetarë të nderuar, unë po e lexoj nocionin, konkluzionin sesi e trajton NATO konceptin e “luftës hibride”. Thotë kështu: “Lufta dhe kërcënimet hibride kombinojnë mjete ushtarake dhe joushtarake, si dhe mjete të fshehta dhe të hapura, duke përfshirë dezinformimin, sulmet kibernetike, presionin ekonomik, vendosjen e grupeve të armatosura të parregullta dhe përdorimin e forcave të rregullta. Metodot hibride përdoren për të mjegulluar linjat midis luftës dhe paqes dhe përpjekje për të mbjellë dyshime në mendjet e popullatave të cenuara, ato synojnë të destabilizojnë dhe minojnë shoqëritë”. Ky është koncepti i luftës hibride.

Tash, çka dimë me të vërtetë? E para, incizimi i publikuar nuk është fake news. Dëgjohet zëri i znj. Kusari, dëgjohet diskutimi për kushtëzimin, pazarin që e kanë këto dy palë ndërmjet vete dhe njëkohësisht kjo vërtetohet prej palës që ka folur. Pra, nuk është fake news. Eliminohet një.

Dy, nuk është shpërqendrim. Në fakt, është fokusim te një problem, i cili e godet në thelb vendimmarrjen demokratike. Pra, largohet edhe elementi i shpërqendrimit.

Nuk është propagandë, për shkak se propaganda bëhet me lajme të rreme. Ky nuk është lajm i rremë. Komunikimi është i drejtë, konfirmohet, e tha edhe deputeti Selmanaj më herët. Konfirmohet nga Kryeministri i Kosovës, bile-bile thotë: “Po të ishte Mimoza në Lëvizjen Vetëvendosje, do të ballafaqohej me komisionin etik që e kanë në parti”. Pra, nuk është lajm i rremë, është lajm i vërtetë.

Dhe, nuk është manipulim, por është përcaktim dhe dokumentim i një të vërtete që përgjatë katër vjetësh është munduar kjo shumicë parlamentare dhe kjo Qeveri ta fshehë. Pse? Për shkak se kanë ardhur me mashtrim, kanë ardhur me manipulim dhe me mashtrim do të shkojnë. Mashtrimi do t'ua zërë frymën më 9 shkurt, për shkak se në secilin element, veç shikoni, ju lutem, logjikën, për të mundur t'i jepet gjykim një kualiteti të një qeverisjeje, të një ekzekutivi, ia këqyr metodat e punës. Kjo Qeveri metodë të punës e ka fshehtësinë, të bëjë diçka fshehtë, të mos merret vesh.

A jemi duke folur për 272 milionë euro të kontratave njëburimore? Kjo nënkupton që nuk e vendos në platformën e konkurrimit publik, ku palët konkurrojnë, ky po do fshehtë ta bëjnë. A po duan ta bëjnë fshehtë, e u mbeti në fyt puna e ushqimit të ushtrisë? A është edhe kjo fshehtë? A janë të fshehta edhe të gjitha marrëveshjet që u dëgjuan në telefon? A janë të fshehta po ashtu edhe të gjitha zotimet që i kanë bërë, në secilin zotim në mënyrë të fshehtë e kanë mbyllur, në secilin të vetëm. Me këto mashtrime, këta mundohen dhe do të punojnë që deri në këta tre-katër muaj ta shpërqendrojnë opinionin publik.

Të nderuar deputetë të opozitës,

E tha edhe Ardiani, më duket, shkoi, neve na pret një detyrë jo e lehtë, një detyrë e ballafaqimit të argumenteve cep më cep Kosovës, ta shpërfaqim një qeverisje, e cila në historinë e Kosovës kurrë nuk ka qenë më e dëmshme, kurrë s'ka qenë më e dobët dhe e cila, për fat të keq, e vendosi Kosovën në pikat që i ka ngritur vetë Akademia e Shkencave e Serbisë. Në qoftë se i lexoni qëndrimet e tyre, i pari është thonë: “Armiqësoje Kosovën me Perëndimin, punoni ta armiqësoni Kosovën me Perëndimin”. Kurrë punët më të armiqësuar nuk i kemi. Jemi nën sanksione të Bashkimit Evropian, përndryshe jemi në nivel më të ulët të marrëdhënieve me SHBA-në.

Thotë: “Paraqiteni Serbinë si viktimë...”

(Ndërprerje nga regjia)

KRYESUESI: Ia zgjatni deputetit kohën edhe dy minuta!

BESNIK TAHIRI: Thotë: “Paraqiteni Serbinë dhe serbët si viktimë”. Kjo është fotografia që e kemi sot. Ndërsa, në esencë, thotë: dëmtojeni shpirtin ndërmarrës dhe ekonominë. Ekonomia kurrë s'ka qenë më e dobët. E kemi detyrë fillimisht institucionale që na takon si subjekte që i përfaqësojmë. Po besoj që e kemi edhe detyrë kombëtare ta shpërfaqim të vërtetën.

Gjykimi i 9 shkurtit do të jetë drita dhe fitorja e opozitës. Me atë fitore, jam i bindur që do të përfundojë një epokë, e cila e ka instaluar standardin e mashtrimit, rrenës dhe gënjeshtërs. Faleminderit!

KRYESUESI: Tash e ftoj për fjalë deputetin Rashit Qalaj.

RASHIT QALAJ: Faleminderit, nënkryetar i Kuvendit!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë,

Të nderuar media,

Këtu përpara i kemi karriget bosh të deputetëve të mazhorancës. Mbrapa i kemi karriget bosh të Qeverisë së Republikës së Kosovës, të cilët pas katër vjet qeverisje, po ashtu janë me rezultate bosh dhe me xhepa plot.

Të nderuar deputetë,

Çka të presim nga një parti politike, nga një mazhorancë këtu në Parlamentin e Kosovës, e cila nuk reagon fare për shkeljet kushtetuese të ministrave të tyre e të Qeverisë së Republikës së Kosovës.

Çka të presim prej kësaj mazhorance, të cilët nuk reagojnë fare që në përbërjen e Qeverisë ka ministra me dënime nga gjykata?

Çka të presim nga kjo mazhorancë këtu në Parlament kur nuk reagon fare, po sulmojnë gardianin e mbrojtjes së Kushtetutës së Kosovës, Gjykatën Kushtetuese? Sulmojnë sistemin e drejtësisë, sulmojnë Prokurorinë, sulmojnë hetuesit policorë, sulmojnë sindikatat, sulmojnë mediat, e mos të flasim për sulmet e fyerjet ndaj deputetëve të opozitës dhe partive politike të opozitës.

Tema që po e bisedojmë në këtë seancë të jashtëzakonshme nuk do të ishte temë për faktin se kryetarja e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes ka diskutuar me deputetin e Parlamentit të Kosovës, Slavko Simiq. Do të ishte krejt normale, se ne si deputetë duhet të flasim, duhet të diskutojmë. Ajo është problem tema, është problem përmbajtja. Është problem që me Slavko Simiq t'i fyesh heronjtë e gjallë që na e sollën lirinë, veteranët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

Është skandal kur znj. Mimoza Kusari-Lila fyen luftëtarin e lirisë, deputetin Ramush Haradinaj, deputeti i cili e ka oborrin plot me varre të vëllezërve dëshmorë që ranë për lirinë e këtij vendi. Është problem dhe skandal për znj. Mimoza Kusari-Lila fyen ushtarin e lirisë, deputetin e Partisë Demokratike, z. Bekim Haxhiu, i cili ka marrë plumba për lirinë e këtij vendi.

Është problem dhe skandal kur kryetarja e Grupit Parlamentar të Vetëvendosjes fyen kryetarin e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike të Kosovës, të cilin e ka bashkëpunëtor një kohë shumë të gjatë.

Është problem kur znj. Kusari-Lila fyen kolegun e saj nga Partia Demokratike e Kosovës, njëherësh nënkryetari Uran Ismaili, për të cilin thotë, është 'gradsko dete', apo "fëmijë qyteti". A thua një deputet që është i lindur në fshat, që ka jetuar në fshat, që është edukuar në fshat, nuk qenka i mirë, për shkak se ka lindur në fshat, apo të gjithë ata banorë të Kosovës, të cilët përbëjnë diku gjashtëdhjetë për qind të Kosovës, lindin, jetojnë, rriten e edukohen në fshat. Po s'është këtu tema.

Problemi është që diku tetëdhjetë a nëntëdhjetë për qind e ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës vijnë nga fshati dhe ata janë njerëz të këqij, për shkak se i kanë prishur rehatinë me Serbinë znj. Kusari-Lila dhe të ngjashmëve.

Pra, ju e dini që njëra nga pyetjet që ia ka bërë deputetit Simiq ka qenë: “A do të dalësh edhe ti në protestë me veteranët?” Paramendojeni që një deputeti të një partie të komunitetit serb t’i thuash: “A po i bashkëngjitësh protestës së veteranëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës?”

E keni bërë në debate televizive se si gënjen, që po kam folur dy-tre minuta, kam folur në gjuhën shqipe, nuk kam folur direkt me Milan Radojçiq, me personin i cili tashmë është terrorist i ndjekur nga institucionet e Kosovës, ndërsa atëkohë ka qenë në listën e zezë dhe sot është në listën e zezë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Qytetarë të nderuar,

Nëse Lëvizja Vetëvendosje dhe kryetarja e grupit të saj parlamentar i bën kërkesë deputetit Simiq dhe merr aprovimin nga Milan Radojçiq, pra koordinohen, ku e kemi ne koordinimin si Qeveri e Kosovës me shtetin shqiptar, me shtetin e Shqipërisë për shumë gjëra të rëndësishme të cilat diskutohen në forume të ndryshme ndërkombëtare rreth integritit të Kosovës në mekanizmat e Bashkimit Evropian dhe në NATO.

Nëse deputetja Kusari-Lila i bën kërkesë dhe merr aprovimin nga Milan Radojçiq, atëherë mendoj që nuk është koordinimi i vetëm. Po shefi i saj, kryeministri Kurti e bën edhe një koordinim tjetër kundër ushtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe ai koordinim është me Mickovskin në Maqedoninë e Veriut për t’i hequr nga qeveria shqiptarët e Maqedonisë që e kanë bërë luftën, veteranët, shokët e Ali Ahmetit, të cilët me gjak e sollën dhe e avancuan të drejtën e shqiptarëve në shtetin e Maqedonisë së Veriut.

Dhe, duke i bërë kërkesa Simiqit dhe duke e marrë aprovimin e Milan Radojçiqit për çështje të tjera, Kurti dhe Qeveria i ndajnë, i përçajnë sa më shumë shqiptarët e Luginës së Preshevës, dhe ky është fakt, kjo është gjendja. Kjo është e tmerrshme.

Dua të them për fund që nuk është me rëndësi se në çfarë rrethanash se si është folur, a është folur direkt, a është folur indirekt, a është folur me telefon, a ka pasur kontakte të tjera apo është diskutuar në mënyrë rrethanore, mirëpo çdo komunikim me Milan Radojçiq është i papranueshëm. Është kundërligjor. Është kundër shtetit. Është kundër interesave nacionale të Republikës së Kosovës.

Dhe, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë duhet sa më shpejt që është e mundur ta shpall zonjën Kusari-Lila, rrezik të papranueshëm për shtetin e Kosovës dhe pastaj organet e drejtësisë të merren me të urgjentisht dhe në mënyrën më strikte të mundshme. Faleminderit!

KRYESUESI: Nuk ka mënyrë më të mirë se sa të lëvizim drejt punimeve të seancës sesa t'ia japësh fjalën Hajdar Beqës.

HAJDAR BEQA: Nënkryetar, faleminderit!

Me të vërtetë të ka hije të jesh kryetar, por rrethanat të kanë sjellë këtu. Po besoj përmirësohet.

Të nderuar qytetarë të Republikës së Kosovës,

Ne sot po diskutojmë në një seancë të jashtëzakonshme për një çështje me të vërtet shumë të jashtëzakonshme deri më tani.

Nuk është vetëm ky problem çka po diskutojmë sot apo çka diskutuam sot, por fatkeqësisht ne çdo ditë po kemi situata të tilla me këtë Qeveri. Kemi vend për shumë seanca të jashtëzakonshme. Për herë të parë nëse dikë e arreston policia, prokuroria, gjykata, deputetët e mazhorancës po dalin e po thonë, janë duke bërë filma.

Në një moment të caktuar kur po hyn ai në burg, po thonë, nuk ka qenë yni. E di, disi po duan ta gjejnë një rrugë për t'u fshehur. Që jam shumë optimist se do të mundohen që të fshihen edhe te Mimoza Kusari-Lila, edhe ka filluar kryeministri, e pamë një deklaratë paraprake që Mimoza nuk është tamam Vetëvendosje, por e kemi marrë me mision si misionare.

Ne dje e pamë që Mimoza e humbi kontrollin. Edhe ato deklaratë që i thoshte dje Mimoza, me të vërtet ka vend që Prokurori i Shtetit ta ftoj, sepse Mimoza tregoi që di shumë. Di shumëçka që ndodh atje, e çka ka ndodhur atje. Di shumëçka çfarë ka në shtëpinë dhe çfarë ka pasur në shtëpinë e Radojçiqit.

U pa dje që edhe disa nga deputetët. Shihej kush ishin viktimat përnjëmend edhe viktimat me dëshirë. U pa dje, bënin zhurmë se e dinin që me të vërtet shfaqja e grupit nuk mund të diskutojmë me Radojçiqin pa pasur miratimin e kryetarit të partisë.

Këtu kemi shefa të grupit, unë jam deputet bukur moti, asnjë shef i grupit nuk mund të thërrasë as si seancë të jashtëzakonshme pa diskutuar të paktën edhe me kryetarin e partisë, e lërë më të diskutojmë në atë nivel se kë ta zgjedh Radojçiqi në Gjykatë Kushtetuese, në institucionin më kredibil të Republikës që e mbron rendin, sigurinë juridike, kushtetuese në këtë vend.

Që të thirret Radojçiqi e të bëjë humor me shokët tanë, të mitë personal të luftës. A doni të dilni në protesta me veteranët. Të thirret Radojçiqi, një kryekriminel, dhe të pyetet për pagën minimale. Tani po dihet pse veteranët kanë qenë të persekutuar nga kjo Qeveri, sepse nuk i ka lejuar Radojçiqi.

Për mendimin tim Radojçiqi dhe Mimoza janë vetëm koordinator për t'i koordinuar veprimet mes Vuçiqit edhe Albin Kurtit.

U tha këtu, por po e them si deputet, si jurist, që Mimoza Kusari ka konsumuar vepër penale. Në momentin që ka komunikuar me një person i cili është, përveç se është në listë të zezë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, është i ndjekur penalisht. Dhe, me dy ligjet të cilat i kemi kaluar në këtë Kuvend, Kodin Penal dhe Kodin e Procedurës Penale, Mimoza Kusari ka shkelur Kodin e Procedurës Penale edhe Kodin Penal, sepse nuk ka treguar ku gjendet i kërkuari nga policia. Dhe në momentin që e di se ku është një kryerës i veprës penale, e ke obligim që të informosh institucionet gjegjëse. Mosveprimi është vepër penale.

Në të njëjtën kohë, kur ligji kali pa veteranët, ligji anti-UÇK, u tha Mimoza me një deklaratë në konferencë që, PDK-ja qëndron prapa asaj që Lista serbe ishte në Kuvend. Dhe, dje ose më datë 9, edhe më herët, besa edhe para 1 viti, u pa qartazi se si ka biseduar zonja Kusari-Lila me Listën serbe edhe për këtë çështje.

Me të vërtetë në një moment të caktuar me dhjetëra, të mos them qindra, veteranë të luftës më kanë thirrur, qysh bre Partia Demokratike ka bërë një veprim të tillë. Në një moment të caktuar, gati fillova edhe unë ta thërras shefin grupit, çka qëndron këtu. Por, e kisha të qartë që nuk mund të ndodh një gjë e tillë nëpërmjet Partisë Demokratike, duke e ditur se kush është Partia Demokratike.

Sot, prapë po e shohim që këta njerëz po duan të fshihen pas veprimeve të tyre. Unë nuk e di, por po më dhimbset Mimoza, sepse këta kanë ikur sot, por dëmi nuk ka ikur. Dëmi na mbetet këtu. Dëmi që po i bëhet vendit, qytetarëve do të na mbesë edhe pas datës 9 shkurt.

Qeveria që vjen do të merret me këto probleme, sepse këto probleme janë shumë të thella. Këto probleme, unë nuk dua të ndalem, por e ftoj përnjëmend prokurorin, Kryeprokurorin e Shtetit, (u.d. prokurori) që të merret me këtë çështje. Të zbardhen këto çështje sa më parë, sepse nuk di çka do t'u thonë Albin Kurti e Mimoza Kusari familjeve të të pagjeturve. Çfarë do t'u thonë familjeve të veteranëve. Familjeve që e kanë humbur krejt familjen për lirinë e Kosovës.

Nuk e di se çfarë do t'i thonë as familjes së Afrim Bunjakut. Nuk di çka do t'i thonë. U doli fytyra e vërtetë e tyre. Nuk e di! Mimoza është mirë të tregoj se me të vërtetë ka qenë misionare dhe në partitë e tjera, duke i përfshirë të gjitha rreshtat këtu.

Nuk besoj që Mimoza ka pranuar të denigrohet deri në këtë masë për interesa të ndonjë grupi të caktuar, dhe tash e pamë që ajo është mirë t'i kërkojë falje opinionit publik dhe të tregojë që ka qenë vetëm një viktimë e Albin Kurtit. Nuk e di se çfarë do t'i thotë nënës Ferdonije Çerkezi kur të vjen në Gjakovë. Nuk e di se çfarë do t'i thotë Mimoza.

Është e lehtë të shkohet aty e t'i thuhet, jemi me ty, por nuk e di se çfarë mund t'i thotë kur të shkojë në Gjakovë. Andaj, jemi këtu ku jemi. Ne e pamë që Radojçiqi ishte i kërkuar nga shteti, e shteti i thoshte, a po ndihmon ta kalojmë ligjin anti-UÇK. Radojçiqi ishte i kërkuar nga shteti, dhe u thoshte, do t'ju ndihmoj nuk ka problem, Mimoza, por duhet edhe disa punë të na i kryej ai shefi yt. Të na i kryej Albini edhe disa punë. Kjo përnjëmend është çështje e rëndë.

Nuk po flas për gjendjen ekonomike, prej arsimtarëve, mësimdhënësve, profesorëve, policëve, infermierëve, ushtrisë, i kemi në gjendje të mjerueshme. Administratën e shtetit. Për të gjitha këto ka vend për seanca të jashtëzakonshme, ka vend për veprime.

Por, sot po flasim për një çështje, edhe ashtu jemi në fund të kësaj legjislature, por nuk ka mundësi që të lejohet në këtë vend, në këtë Republikë, që ky shtet u la me gjak, të koordinohemi për agjendë shtetërore me njerëzit të cilët janë të kërkuar edhe janë në fletë-arrest nga vetë shteti, sepse atëherë nuk ka kuptim funksionimi as i Qeverise, as nuk ka kuptim funksionimi i këtij Parlamenti, po as i Republikës.

Andaj, edhe njëherë, kërkoj që t'i marrim të gjitha masat dhe të mos shkojmë me tutje. Kjo temë duhet të jetë këtu aktuale derisa Mimoza Kusari-Lila ta tregojë rolin e vet. A e ka bërë me dëshirë. A ka qenë nën presion të Albinit dhe të Dejonës dhe të tjerëve, a siç ka qenë, s'është e lehtë t'i qesësh në këtë gjendje edhe deputetët që kanë marrë përgjegjësi, e po ju duhet, fatkeqësisht u shkoj krejt mandati duke i ikur përgjegjësisë.

Lere betimin e deputetit, se edhe ajo është shkelje e Kushtetutës dhe është shkelje e ligjit nëse ti e shkel atë. Unë ju falënderoj dhe dëshiroj që me të vërtet të marrim masa, ndërkaq masën kryesore duhet ta marrin qytetarët e vendit dhe njerëzit të cilët nuk iu ikin kur duhet të jenë aty që të mos u rrimë prapa.

Këta ikin, kanë ikur gjithnjë. Do të ikin edhe pse këtu është NATO nuk do të ketë luftë, po kështu do t'i kesh këta edhe nëse ndonjëherë ndodh një luftë në Kosovë, kështu do t'i kesh. Asnjë s'do ta kesh këtu. Edhe ata që duan të vijnë, nëse është ndonjë prej tyre, nuk e lënë të vijë. Faleminderit!

KRYESUESI: Ftoj deputeten Zejnullahu nga Partia Demokratike e Kosovës që ta marrë fjalën dhe deputetja është e fundit për këtë seancë.

FLORETË ZEJNULLAHU: Faleminderit, nënkryetar!

Të nderuar kolegë deputetë,

Të dashur qytetarë të Republikës së Kosovës,

Sot, Kosova ndodhet përballë një Qeverie përveçse të dështuar në të gjithë sektorët, një Qeveri me njerëz bashkëpunëtorë të kriminelëve serbë.

Ditëve të fundit dolën edhe dëshmi të reja, të cilat i dhanë vulë edhe një herë asaj që kemi thënë që nga fillimi, se kjo Qeveri ka në udhëheqje njerëz me prejardhje të dyshimtë që nuk e kanë prioritet interesin e mbrojtjen e Republikës së Kosovës, por të atij vendi nga i cili edhe kanë gjenet në ADN-në e tyre.

Dje u vërtetua edhe një herë se shefja e Grupit të Vetëvendosjes dhe Albin Kurti nuk e dinë as ku fillon Kosova dhe ku përfundon Serbia. Pas publikimit të incizimeve, ku u vërtetua edhe një herë bashkëpunimi i saj me kriminelin Milan Radojçiq dhe Serbinë, çdo fjalë e saj është një thikë në zemër për secilin ushtar të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Është një thikë në zemër për secilën familje të dëshmorëve, e atyre që lanë gjymtyrët në luftën e fundit në Kosovë.

Me një pafytyrësi të paparë, Albin Kurti përpiqet sot t'ia faturojë marrëveshjet e tij, PDK-së. Marrëveshjet e tij të pista e të errëta me Vuçiqin dhe me Serbinë.

Pse duhet të habitemi? Ky është regjimi që i ka kthyer veteranët në mëshirën e rrugës, që rri duarkryq teksa krerët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjykohen padrejtësisht në Hagë. Çdo veprim i tyre është një akt tradhtie ndaj vendit tonë dhe askush nuk duhet të heshtë përballë këtij krimi.

Albin Kurti e vartësja e tij, Mimoza Kusari, të cilët duket se kanë më shumë miqësi me strukturat kriminale serbe sesa me popullin e Kosovës, po luajnë me jetën dhe fatin e secilit qytetar të këtij vendit.

Ku janë premtimet e mëdha që ua servuan si garanci qytetarëve për një jetë më të mirë? Çfarë ka sjellë kjo Qeveri për qytetarët e saj përveç gënjim, mashtrim dhe frustrim. Në katër vite kemi parë veç 2 km asfalt të shtruar dhe një urë të vogël. Ky është kulmi i mundësive të tyre. Ndërkohë, pensionet janë rritur vetëm 20 euro, një shtesë që nuk e mbulon as inflacionin, e lërë më të sigurojë një jetë të dinjitetshme për pensionistët tanë.

Në diplomaci bilanci është edhe më i zi. Asnjë njohje e re për Republikën e Kosovës. Miqtë tanë të përhershëm ndërkombëtarë sot i shohim duke u larguar nga Kosova. Pse? Sepse kjo Qeveri nuk di të ndërtojë aleanca strategjike, por vetëm të ngjallë tensione dhe kriza, sepse ky është misioni i tyre.

Të mos harrojmë aferat e mëdha të Albin Kurtit që e kanë tronditur shtetin tonë. Afera e rezervave shtetërore, ku u zhduken produktet bazë, si vaji, mielli dhe gruri në mes të krizës, duke lënë popullin tonë në pasiguri ushqimore.

Afera e rrymës, ku çmimi u rrit me 130%, duke e shkatërruar buxhetet familjare, ndërsa Martin Berishaj, ambasador i besuar i Albin Kurtit dhe Vjosa Osmanit, kapet duke tregtuar miliona euro me Serbinë.

Afera e borxheve të ujit. Një akt korruptiv, ku miliona euro u falën në dëm të qytetarëve që mezi mbijetojnë. Tenderë sekretë me vlerë rreth 275 milionë euro, të shpërndara pa asnjë transparencë. Një grabitje e pastër ndaj buxhetit të Kosovës.

Sot, administrata publike, mësimdhënësit, mjekët, infermierët dhe punëtorët e Kosovës janë në mëshirën e fatit. Sot, kjo Qeveri i ka lënë ushtarët dhe policët tanë pa uniforma e pa përkujdesje bazike, duke e zhytur shtetin në një kaos institucional. Sot, ushtarët e Kosovës janë edhe pa ushqim.

Këto janë vetëm disa nga aferat e turpshme të këtij regjimi të korruptuar, i cili e përdor pushtetin vetëm për përfitime personale dhe për të çuar përpara misionin të cilin e ka për ta kthyer Serbinë në Kosovë.

Ne nuk duhet të biem nën hegjemoninë e Vetëvendosjes dhe Albin Kurtit, kësaj partie dhe këtij njeriu që vepron si dorë e zgjatur e Serbisë. Albin Kurti dhe instrumentet e tij si Dejana Mihali e Mimoza Kusari dhe të tjerët duhet të japin llogari për veprimet e tyre që kanë bërë dhe të japin përgjigje këtu në Kuvend para qytetarëve për pyetjet të cilat i kemi ngritur.

KRYESUESI: Faleminderit, zonja deputete!

Tash e ftoj propozuesin e kësaj seance të jashtëzakonshme, zotin Tahiri që ta lexojë draft-rezolutën.

ABELARD TAHIRI: Faleminderit kryesues, nënkryetar i Kuvendit, zoti Hoxhaj!

Të nderuar kolegë deputetë,

Para se ta lexoj këtë draft-rezolutë të propozuar nga 42 deputetë të kësaj legjislature, duhet ta them një gjë; e dëgjova me vëmendje dhe pothuajse secili deputet që foli sot, i bëri thirrje Mimoza Kusari-Lilës që t'i publikojë pamjet të cilat ata i posedojnë nga vila e Radojçiqit.

Në fakt, prita goxha kështu me kureshtje, sepse e di që janë duke na ndjekur në vazhdimësi, dhe thosha ndoshta vijnë gjatë seancës edhe i prezantojnë. Në fakt, të dashur qytetarë të Kosovës, vetëm një fotografi ekziston me Radojçiqin në Kosovë, fotografia e Mimoza Kusari-Lilës me Lëvizjen Vetëvendosje.

Nuk do të mund të gjeni kurrë as edhe një herë, as një qytetar tjetër në bashkëpunim me Radojçiqin përpos linjës që shkon nga Lëvizja Vetëvendosje. Të jeni të bindur që çfarëdo që të kishin pasur ata, sot, dje, pardje, do t'i publikon moti. Nuk do të vinte rendi që ne t'i lusnim hiç,

ata do t'i publikonin. Por, s'kanë. As edhe një të vetme. Vetëm një fotografi ekziston në Kosovë e Radojçiqit, ajo me Lëvizjen Vetëvendosje dhe me Mimoza Kusari-Lilën.

Të nderuar kolegë deputetë,

Po jua prezantoj rezolutën e propozuar nga 42 deputetë të kësaj legjislature.

Draft-Rezolutë

1. Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga Prokurori i Shtetit si institucion kushtetues dhe i pavarur, me autoritet dhe përgjegjësi për ndjekje penale, që të iniciojë hetim penal në përputhje me legjislacionin në fuqi ndaj kryetares së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, zonjës Mimoza Kusari-Lila, lidhur me komunikimet e saj me kryeterroristin Milan Radojçiq.

2. Po ashtu, Kuvendi i Kosovës kërkon nga Grupi Parlamentar i Lëvizjes Vetëvendosje shkarkimin e Mimoza Kusari-Lila nga funksioni i kryetares së grupit parlamentar. Faleminderit!

KRYESUESI: Faleminderit, zoti Tahiri!

Të nderuar deputetë,

Zonja dhe zotërinj,

Meqë nuk kemi kuorum të domosdoshëm, unë i ndërpres punimet e kësaj seance. Për kohën se kur vazhdojmë, ju informoj. Faleminderit!

* * *

E mërkurë, më 30 tetor 2024

Vazhdimi i mbledhjes së jashtëzakonshme, e filluar më 11 tetor 2024

Mbledhjen e drejton kryetari i Kuvendit, z. Glauk Konjufca.

KRYETARI: Të nderuar deputetë,

Tash do ta trajtojmë një çështje që e patëm më 11 tetor, e që është:

1. Votimi i Projekt-Rezolutës nga debati parlamentar për komunikimet e kryetares së Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje Mimoza Kusari - Lila me Milan Radojçiq

Të nderuar deputetë,

E keni parë rezolutën. Diskutimet janë shterur. E qesim në votim këtë rezolutë. A jeni të gjithë? Votojmë tash. Kush po bën presion bre?! S'kemi kuorum. E, ose edhe një herë? A ishit në sallë apo jo? Epo, tash! Votojmë prapë. Votojmë tash për rezolutën.

60 vota kundër, 1 deputet votoi për. Jo ka gabuar, por për mësysh ma merr mendja. Kështu që, konsideroj që rrëzohet kjo rezolutë.

E përgatiti:

Njësia për Transkriptim dhe Lekturë